

PLANI I KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Prof.Dr. NURAN ZEREN GÜLERSOY

Dr. ENGIN EYÜBOĞLU

TURGAY KEREM KORAMAZ

PINAR ABACILAR

Prof.Dr. ZEYNEP AHUNBAY (Keshilluese)

SHEND KABASHI (Planer lokal)



PLANI I KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

KORDINATOR I PROJEKTIT

Prof.Dr. Nuran ZEREN GÜLERSOY (Arkitekt / Planer Urban)
Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Fakulteti i Arkitekturës / Departamenti i
Planifikimit Urban dhe Regjional

STAFI I PROJEKTIT

Dr. Engin EYÜBOĞLU, (Planer Urban)
Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Fakulteti i Arkitekturës / Departamenti i
Planifikimit Urban dhe Regjional

Kerem KORAMAZ (Urban Planner)
Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Fakulteti i Arkitekturës / Departamenti i
Planifikimit Urban dhe Regjional

STAFI TEKNIK

Pınar ABACILAR, (Arkitekt)
Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Qendra për Planifikim dhe Hulumtim Mjedisor

KONSULTANT I PROJEKTIT

Prof.Dr. Zeynep AHUNBAY (Arkitekt)
Universiteti Teknik i Stambollit (ITU) Fakulteti i Arkitekturës / Departamenti i
Arkitekturës / Divizioni i Restaurimit

Shend KABASHI (Planer Lokal)

Tetor, 2008

PËRMBAJTJA

HYRJA	5
PËRMBAJTJA DHE METODAT E STUDIMIT	6
1. PËRSHKRIM I SHKURT I PRIZRENIT	8
1.1. Prizreni dhe Pozicioni i Tij.....	8
1.2. Karakteristikat Natyrore dhe Topografike të Prizrenit.....	10
1.3. Historia e Prizrenit.....	11
1.4. Karakteristikat e Popullsisë në Kosovë dhe Prizren.....	17
1.5. Karakteristikat Ekonomike të Prizrenit.....	18
1.6. Shërbimet Sociale, Shëndeti dhe Edukimi.....	20
2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT	21
2.1. Qëllimet e planifikimit në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit.....	21
2.2. Objektivat e planifikimit në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit.....	22
2.2.1. Kualifikimi Funkcional.....	22
2.2.2. Komunikimi Optimal.....	23
2.2.3. Integrimi Social dhe Kulturor.....	23
2.2.4. Mjedi pozitiv për Kualitetin Arkitektonik dhe Urban.....	23
2.2.5. Kushtet Pozitive për Shëndet dhe Qetësi.....	24
2.2.6. Cmimi Optimal dhe Përkrahja Ekonomike.....	24
2.2.7. Fleksibiliteti dhe Zbatueshmëria.....	24
3. STUDIMI DHE ANALIZAT E ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT	25
3.1. Modeli i transportit në Zonen Historike të Prizrenit.....	29
3.2. Vëzhgimi i Hapësirave dhe Ndërtesave Individuale.....	30
3.2.1. Shfrytëzimi i Tokës dhe Ndërtesave.....	30
3.2.2. Gjendja e ndërtesave.....	36
3.2.3. Lartësia e Kateve të Ndërtesave.....	38
3.2.4. Materialet e ndërtimit.....	40
3.2.5. Zotërimi i Ndërtesave.....	42
3.2.6. Harmonija me karakterin Arkitektural të Zonës.....	44
3.2.7. Ndërtesat Monumentale.....	47
3.3. Analizat e Strukturës Sociale.....	54
3.3.1. Struktura Demografike.....	55
3.3.2. Marrdhëniet Ndërtesë-Shfrytëzues.....	59
3.3.3. Komunikimi social- Niveli i Bashkëveprimit.....	63
3.3.4. Evaluimi i ambientit fizik.....	65
3.3.5. Opinionet e Shfrytëzuesve për Planin e Konservimit.....	65
4. EVALUIMI DHE VENDIMET PLANIFIKUESE NË PLANIN E KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT	67
4.1. Evaluimi i Studimit dhe Formulimi i Kriteve për Projektim.....	68
4.2. Projekti Preliminar.....	74
4.2.1. Vendimet në Lidhje me Banim.....	77
4.2.2. Vendimet në Lidhje me Tregtinë- Aktivitetet e Përdorimit të Përzier.....	78
4.2.3. Vendimet në Lidhje me Lehtësirat Sociale dhe Kulturore.....	80
4.2.4. Vendimet në Lidhje me Transportin.....	81
4.3. Projekti.....	84
4.4. Direktivat e Projektit Urban.....	93
4.4.1. Karakteristikat Projektuese të Zonës.....	94
4.4.2. Strukturat e Projektit Urbanistik të Prizrenit.....	101
4.4.3. Intervenimet në Arkitekturën Qytetare.....	102
4.4.4. Ndërtimet e Reja dhe Kërkesat e Drejtpërdrejta.....	110
REFERENCAT	117

LISTA E TABELAVE

Tabela 3.1. Shfrytëzimi i Tokës dhe Ndërtesës-Kati Përdhe	30
Tabela 3.2. Shfrytëzimi i Tokës dhe Ndërtesës-Kati Parë	30
Tabela 3.3. Gjendja e Ndërtesave	36
Tabela 3.4. Etazhiteti i Ndërtesave	38
Tabela 3.5. Materialet e Ndërtimit	40
Tabela 3.6. Zënia e ndërtesave	42
Tabela 3.7. Harmonia me karakterin Arkitektural të Zonës.....	44
Tabela 3.8. Madhësia e Familjeve	55
Tabela 3.9. Moshë e Nënave	55
Tabela 3.10. Edukimi i Nënave.....	56
Tabela 3.11. Profesionit i Nënave	56
Tabela 3.12. Të ardhurat e Nënave.....	57
Tabela 3.13. Moshë e Babait.....	57
Tabela 3.14. Edukimi i Babait.....	58
Tabela 3.15. Profesionit i Babait	58
Tabela 3.16. Të ardhurat e Babait.....	59
Tabela 3.17. Pronësia e Automjeteve	59
Tabela 3.18. Pronësia e Tokave.....	59
Tabela 3.19. Periudha e Banimit	60
Tabela 3.20. Vendi i Banimit të Mëparshëm	60
Tabela 3.21. Karakteristikat e Shtëpisë më parë	60
Tabela 3.22. Dëshira për Shpërngulje në Shtëpi Tjera	61
Tabela 3.23. Vendi i dëshiruar për tu Shpërngulur	61
Tabela 3.24. Tipi i Banimit të Preferuar	61
Tabela 3.25. Kënaqshmëria e Shtëpisë.....	62
Tabela 3.26. Dëshira për përmirësimin e kushteve të shtëpisë.....	62
Tabela 3.27. Preferencat e Intervenimit	62
Tabela 3.28. Të afërmit e tjerë në Prizren.....	63
Tabela 3.29. Marrëdhëniet Interaktive me fqinjët.....	63
Tabela 3.30. Marrëdhëniet e ngrohta me fqinjët.....	63
Tabela 3.31. Vendet e Zakonshme për mbledhjet me Fqinjë	64
Tabela 3.32. Dëshira për të marrë pjesë në Zbukurimin e Lagjes së bashku me Fqinj të tjerë.....	64
Tabela 3.33. Dëshira për të marrë rolin organizativ në Zbukurimin e Lagjes.....	64
Tabela 3.34. Knaqësia me Shërbimet Komunale	65
Tabela 3.35. Përceptimi i Shfrytëzuesit për Konservimin e Prizrenit	65
Tabela 3.36. Përceptimi i Shfrytëzuesit në lidhje me Ndërrimin e Objektit Ekzistues me një Objekt moc dhe Ob Shumëkatësh.....	65
Tabela 4.1. Databaza e ndërtesave e Gjeneruar me sistemin GIS	68
Tabela 4.2. Databaza e Ndërtesave duke pasur parasysh Strukturën e Listuar dhe Ndërtesat Tjera.....	69
Tabela 4.3. Propozimi për Distribuirimin e Tokës dhe Shfrytëzimit të Ndërtesave.....	75
Tabela 4.4. Vendimet e Planifikimit.....	76
Tabela 4.5. Struktura e Direktivave të Projektit Urbanistik	93
Tabela 4.6. Lista e ndërtesave Monumentale të cilat janë propozuar për restaurim	101
Tabela 4.7. Direktivat për Volumenin e secilës Zonë.....	110

LIST E FOTOGRAFIVE (FIGURAVE)

Fig. 1.	Metoda e Studimit.....	7
Fig.1.1.	Vendëndodhja e Kosovës	8
Fig.1.2.	Sektorët e Kosovës	9
Fig.1.3.	Prizreni dhe Vendbanimet në rrethinë	10
Fig.1.4.	Arasta dhe rrethina e saj në fillim të shekullit	12
Fig.1.5.	Arasta dhe rrethina e saj , 2006	12
Fig.1.6.	Modeli Historik Urban i Prizrenit	13
Fig.1.7.	Hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe rrethina në fillimin e shekullit.....	14
Fig.1.8.	Hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe rrethina , 2006	14
Fig.1.9.	Kalaja në fillim të shekullit	15
Fig.1.10.	Kalaja , 2006	15
Fig.1.11.	Siljeta Urbane e Nënkalasë në fillim të shekullit	16
Fig. 1.12.	Siljeta e Nënkalasë , 2006	16
Fig. 1.13.	Piramida e Popullsisë së Kosovës	17
Fig.1.14.	Distribucimi Etnik në Kosovë në vitin 2000	17
Fig. 3.1.	Pamje e Përgjithshme e Zonës Historike të Prizrenit.....	25
Fig.3.2.	Kufijt e Zonës Historike të Prizrenit	26
Fig. 3.3.	Siljeta e Përgjithshme e Zonës Historike të Prizrenit	26
Fig.3.4.	Siljeta e Zonës Historike të Prizrenit.....	27
Fig. 3.5.	Harta e zonave të ndërtuara dhe të pandërtuara	28
Fig.3.6.	Harta e modelit të Transportit në Zonën Historike të Prizrenit	29
Fig.3.7.	Harta e shfrytëzimit të Tokës dhe Objekteve – Kati Përdhe.....	31
Fig.3.8.	Objektet e Banimit	32
Fig.3.9.	Harta e shfrytëzimit të Tokës dhe Objekteve – Kati Parë	33
Fig.3.10.	Ndërtesat Religjioze	34
Fig. 3.11.	Ndërtesat Tregtare	35
Fig. 3.12.	Ndërtesat dhe Gjendja e tyre	36
Fig.3.13.	Harta e Gjendjes së Ndërtesave.....	37
Fig. 3.14.	Ndërtesat dhe Etazhiteti i tyre	38
Fig. 3.15.	Harta e Etazhitetit të Ndërtesave	39
Fig. 3.16.	Ndërtesat dhe Materialet e Tyre të Ndërtimit.....	40
Fig. 3.17.	Harta e Materialeve të Përdorura	41
Fig. 3.18.	Ndërtesat dhe Gjendja e tyre e Shfrytëzimit.....	42
Fig.3.19.	Harta e Shfrytëzimit të tyre.....	43
Fig. 3.20.	Ndërtesat në Harmoni	44
Fig. 3.21.	Harta e Ndërtesave në Harmoni me Karakterin Arkitektonik të Zonës.....	45
Fig. 3.23.	Ndërtesat Monumentale.....	52
Fig. 3.24.	Harta e Ndërtesave Monumentale.....	53
Fig. 3.25.	Njësitë tradicionale të banimit dhe Karakteri Urban i Zonës Historike të Prizrenit	54
Fig. 3.26.	Hapësirat Urbane të Hapura përgjatë Bregut të lumit.....	54
Fig. 3.27.	Jeta Sociale në Prizren	66
Fig. 4.1.	Planifikimi i Zonave duke u bazuar në Evaluimin e Studimit	70
Fig. 4.2.	Revidimi i Planifikimit të Zonave me Studimet paraprake planifikuese	71
Fig. 4.3.	a.Karakteristikat e Planifikimit të Zonave me Potencial, Probleme dhe Propozime	72

Fig. 4.3.	b. Karakteristikat e Planifikimit të Zonave me Potencial, Probleme dhe Propozime	73
Fig. 4.4.	Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit	74
Fig. 4.5.	Zonat e Banimit në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit	77
Fig. 4.6.	Zonat e Shfrytëzimit të Përzier në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit	78
Fig. 4.7.	Zonat e Shfrytëzimit Tregtar dhe Zyrrave në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit..	79
Fig. 4.8.	Lehtësirat Sociale dhe Kulturore në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit.....	80
Fig. 4.9.	Sistemi i Transportit në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit.....	82
Fig. 4.10.	Sistemi i Transportit Masiv në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit.....	83
Fig. 4.11.	Tetë Zonat e Planifikimit të Zonës historike të Prizrenit	84
Fig. 4.12.	Vendimet Planifikuese për Zonën Tradicionale Tregtare	85
Fig. 4.13.	Vendimet Planifikuese për Bliqet e Ndërtesave të Larta	86
Fig. 4.14.	Vendimet Planifikuese për Zonën e Bregut të Lumit.....	87
Fig. 4.15.	Vendimet Planifikuese për Zonën e Nënkalasë	88
Fig. 4.16.	Vendimet Planifikuese për Zonën e Aksit Tregtar	89
Fig. 4.17.	Vendimet Planifikuese për Zonën e Banimit dhe Shfrytëzimit të Përzier	90
Fig. 4.18.	Vendimet Planifikuese për Zonën Organike të Banimit.....	91
Fig. 4.19.	Vendimet Planifikuese për Zonën e Banimit sipas Trendeve Ndërtuese aktuale	92
Fig. 4.22.	Karakteristikat e Projektimit për Zonën e Nënkalasë.....	96
Fig. 4.23.	Karakteristikat e Projektimit për Zonën e Aksit Tregtar	97
Fig. 4.24.	Karakteristikat e Projektimit për Zonën e Banimit dhe Shfrytëzimit të Përzier	98
Fig. 4.25.	Karakteristikat e Projektimit për Zonën Organike të Banimit	99
Fig. 4.26.	Karakteristikat e Projektimit për Zonën e Banimit sipas Trendeve Ndërtuese aktuale	100
Fig. 4.27.	Projekti i Zonës së Tregtisë dhe Banimit	103
Fig. 4.28.	Projekti i Zonës së Nënkalasë	105
Fig. 4.29.	Propozimi i Pejshazhit të Qytetit.....	107
Fig. 4.30.	Propozimi i Pejshazhit të Qytetit I	109

1. HYRJE

Në muajin Maj të vitit 2006, Komuna e Prizrenit së bashku me CHwB nënshkruan "Memorandumin e Mirëkuptimit për Implementimin e Programit të Rehabilitimit të Zonës Historike të Prizrenit". Ky Program përfshin edhe komponentë tjera që janë të rëndësishme për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonës historike.

"Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit" është njëri nga hapat konkret drejt planifikimit dhe ruajtjes së kësaj zone historike. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në zhvillimin urban është me rëndësi të madhe në mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave historike në qendrat urbane. Kjo është njëra nga iniciativat e komunave në Kosovë në hartimin e Planit të Konservimit të Zonave Historike.

Studimi i "Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit" është përgatitur duke u bazuar në konceptin e ndryshimit të konservimit në drejtim të kuptimit të revitalizimit, koncept ky që vë në pah çështjet të cilat kanë të bëjnë me rikthimin e vlerave kulturore të karakterit urban tradicional dhe karakterit arkitektonik me përcaktimin e intervenimeve fizike të nevojshme për përdorimin dhe ripërdorimin duke pasur parasysh relacionet hapësinore urbane.

Evalumi i ambientit historik të Prizrenit dhe vendimet zhvillimore në kuadër të procesit të planifikimit kërkon qasje integruese të konservimit, planifikimit dhe strategji të dizajnit urban bazuar në dokumentacion gjithëpërfshirës. Hulumtimet dhe studimet konservuese të kaluara në lidhje me rajon janë hulumtuar dhe evaluar gjatë këtij studimi. "Draft Normativat për Ruajtjen e Zonës Historike të Prizrenit" dhe "Plani Pilot për Mbrojtje dhe Zhvillim të Zonës Historike", të cilat janë hartuar nga koordinimi i Politeknikos së Torinos përkrahur nga stafi i zyres së CHwB në Kosovë janë evaluar dhe përdorur në mënyrë të veçantë në fazën e hulumimeve dhe analizave. (CHwB dhe Politekniku i Torinos, 2005).

Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit ka për qëllim të formulon determinantet që përmbajnë një zhvillim të duhur dhe bashkëkohor të cilësisë mjedisore të Zonës Historike të Prizrenit, me ruajtjen e vlerave historike, arkitekturale dhe funksionale

1.1. PËRMBAJTJA DHE METODA E STUDIMIT

Në këtë projekt, Zona e Parë e Mbrojtjes e Zonës Historike të Prizrenit është trajtuar si zonë studimi. Studimi përmban një gjendje të shkurtër mbi arealin historik dhe historinë e Prizrenit; qëllimet dhe objektivat e aktiviteteve për konservim dhe zhvillim. Studimi gjithashtu përfshin analiza të zonës lidhur me transportin në zonën e planifikuar, shfrytëzimin e tokës dhe shfrytëzimin e ndërtesave në katin përdhe dhe katin e parë, gjendjen e ndërtesave , etazhitetin e ndërtesave, materialet ndërtimore, pronat, zotërimin e ndërtesave , përshtatshmëria e ndërtesave me strukturën fizike të zonës dhe rrethinës së saj, studimi gjithashtu përbëhet nga studimet sociale me qëllim që të shfaqin aspektet demografike, sociale dhe kulturore të banorëve të ndërtesave që gjenden në listë dhe jashtë saj.

Vendimet përkitazi me planifikim dhe konservim janë zhvilluar duke marrë në konsiderim studimet e niveleve më të larta (Forumi Europa Nostra dhe Takimet përgaditore 2006; Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe Nixha Partneres, 2003), hulumtimet dhe studimet e inventarizimit për mbrojtje të monumenteve dhe zonave (Koçbashliu, 2006; Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve IMM dhe CHwB; Rexha, 2004)

Vlerësimi i studimit në dimensionin e punës në terren dhe shpjegimit të vendimeve mbi konservim që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e tokës dhe të ndërtesave, cilësinë urbane dhe të transportit, pronat e regjistruara dhe pa regjistruara, zhvillimit socio-kulturor duke u bazuar në qëllimet dhe objektivat e thëna në studim. Pas evaluimit të gjithë zonës konservuese, zona historike është e ndarë në nën-zona dhe kushtet egzistuese dhe pritjet për të ardhmen u determinuan në propozimet hapësinore, shoqërore dhe politike që janë zhvilluar për të ardhmen e Prizrenit.

Në këtë aspekt, vendimet lidhur me transportin, vendimet lidhur me shfrytëzimin e tokës, vendimet lidhur me intervenimet fizike në objektet e listuara, vendimet lidhur me strukturat tjera që duhet të konservohen dhe vendimet re-strukturuese lidhur me parcelat e zbrazëta janë paraqitur në plan. Në fazën e fundit të planit studiues jnaë zhvilluar poashtu edhe Udhëzuesit e Dizajnit të Planit të Konservimit të Prizrenit. Metoda e studimit të Planit të Konservimit dhe Zhvillimit te Zonës Historike te Prizrenit është paraqitur ne fig.1




Fig 1. Metodologjia e studimit

2. PËRSHKRIM I SHKURTËR I PRIZRENIT

2.1. PRIZRENI DHE LOKACIONI I TIJ

Reoublika e Kosovës është një shtet i vogël në qendër të Gadishullit Ballkanik. Kosova kufizohet me Maqedoninë (IRJM), Shqipërinë, Serbinë dhe Malin e Zi. Ka sipërfaqe 10 877 km². Bazuar në Rezolutën 1244 të 12/6/1999 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Kosova ka qenë territor i administruar nga Administrata Civile e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ka qenë e prezantuar nga Sekretari Gjeneral i Kombeve të Bashkuara anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të KB më 26 Mars 2007. Në Deklaratën e saj të Pavarësisë më 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shprehi përkushtimin e tij për implementim të plotë të marrëveshjes. Provizionet e Marrëveshjes janë përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të aprovuar më Kuvendin e Kosovës më 9 Prill 2008.



Fig 2.1. Shtrirja e Kosovës

Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina. Kosova është e ndarë në 7 regjione / sektorë dhe 30 njësi administrative (komuna). Këta sektorë janë Ferizaj, Gjakova, Gjiilan, Mitrovica, Peja, Prishtina, Prizren. Komunat janë: 1. Deçan, 2. Dragash, 3. Ferizaj, 4. Fushë - Kosovë, 5. Glllogoc, 6. Gjakova, 7. Gjiilan, 8. Istog, 9. Kaçanik, 10. Kamenica, 11. Klina, 12. Leposaviq, 13. Lipjan, 14.

Malisheva, 15. Mitrovica, 16. Novobërda, 17. Obiliq, 18. Peja, 19. Podujeva, 20. Prishtina, 21. Prizren, 22. Rahovec, 23. Skenderaj, 24. Suhareka, 25. Shtërpce, 26. Shtime, 27. Viti, 28. Vushtri, 29. Zveçan dhe 30. Zubin – Potok (Komuna e Prizrenit, 2007).

Komuna e Prizrenit gjendet në Jug të Kosovës dhe përmban sipërfaqe prej 640 km² (63,871.68 ha); kjo vlerë përmban 5.94 % të territorit të përgjithshëm të Kosovës. Prizreni në perëndim ndanë kufirin me Shqipërinë, në jug me Komunën e Dragashit, në juglindje me Maqedoninë, në lindje me Komunën e Shtërpçës, në verilindje me Komunën e Suharekës, në veri me Komunën e Rahovecit dhe në veriperëndim me Komunën e Gjakovës. Qendra e Komunës së Prizrenit është qyteti i Prizrenit (Komuna e Prizrenit, 2002).




Fig 2.2. Regjionet / sektorët e Kosovës

Largësia nga Prizreni në Prishtinë është 77 km, në Suhareke është 18 km, më Rahovec 32 km, më Malisheve është 45 km dhe Dragash është 37 km.

2.2. KARAKTERISTIKAT NATYRORE DHE TOPOGRAFIKE TË PRIZRENIT

Komuna e Prizrenit gjendet në lartësinë mbidetare 412 - 500 m. Është e rrethuar me Malet e Sharrit, të cilat pikën më të lartë e arrijnë 2,748 m. Komuna e Prizrenit ka një rrjet të pasur dhe të ngjeshur të lumenjve. Lumenjtë rrjedn drejtë Drinit të Bardhë dhe Detit Adriatik. Lumenjtë të cilët rrjedhin nga Mali i Sharrit janë të shumë shpejtë dhe të thellë, dhe kanë çarje të ngushta, të cilat shpesh formsëojnë kantonet. Këto lumenj janë në gjendje ta mbajnë nivelin e ujit për shkak të shkrirjes së borës nga Mali i Sharrit. Rrjedha mesatar e ujit të lumit është 56 m³/sekondë dhe rezervari i tij ka sipërfaqe totale prej 18,592 km² (Komuna e Prizrenit; 2002).

Në Komunën e Prizrenit dominon klima kontinentale për shkak të maleve të afërta të cilat e rrethojnë komunën. Klima Mediterane gjithashtu depërton në Komunën e Prizrenit nga rrymat e Adriatikut që vijnë nëpërmjet kanjonit të Drinit të Bardhë. Kjo klimë ndihmon në kultivimin e rrushit si dhe pemëve dhe perimeve të tjera. Temperatura vjetore mesatare në Komunën e Prizrenit është 12.5 OC, me temperaturën më të ulët 1.3 OC gjatë muajit Janar dhe me temperature me të lartë 23.2 OC gjatë muajit Korrik.(Komuna e Prizrenit; 2002).




Fig 2.3. Prizreni dhe vendbanimet që rrethojnë atë

2.3. HISTORIA E PRIZRENIT

Prizreni, Theranda antike, gjatë periudhave të ndryshme historike shfaqet si një qendër e madhe ekonomiko-kulturore. E ndeshim me emra të ndryshëm. Sipas dokumenteve latine: Prisren, Prisrenum, Presarin, Prisarano, Prisreno, Prisor, Pristren, Prisarini, Jorsaim, etj. ; bizantinët e quajtën Prisdriana, Prezren, Prizorian; në dokumente osmane e ndeshim me emrat: Tarzerin, Perserin, Prizerin, Zerín, etj.; në dokumente sllave ndërkaq e ndeshim me emrat: Prizren, Prezren, Prizrin, Prizdren, Prezdrin, etj.

Trashëgimia Kulturore e Prizrenit reflekton historinë e mrekullueshme të qytetit me një kulturë të shtresuar gjatë shekujve deri në ditët e sotme. Duke zotëruar një pozitë të mirë gjeografike dhe gjeopolitike, Prizreni gjithmonë është gjendur në udhëkryq të kulturave të mëdha, si dhe të kulturave etnike, të cilat kanë jetuar njëra pranë tjetrës, si: dardano-iliro-shqiptare, romake, bizantine, serbe, turko-osmane, etj. Në qytetin e Prizrenit gjatë shekujve fliteshin disa gjuhë zyrtare.

Prizreni në antikitet njihet me emrin Theranda, dhe u zhvillua historikisht në rrugët e tregtisë së Ballkanit. Gjatë periudhës së Bizantit qyteti është quajtur Prisdriana. Në vitin 1018/1019 sipas Kartës së perandorit bizantin Bazili II, Prizreni përmendet si peshkopatë nën juridiksionin e Kryepeshkopatës së Ohrit. Në vitin 1072 nën udhëheqjen e George Voiteh-ut u zhvilluar kryengritja e popujve të Ballkanit kundër pushtetit të perandorit bizantin Mihali VII Duka, kryengritje kjo që u shua në vitin 1073. Menjëherë pas Kryqëzatës së Katërtë më 1204 Prizrenin e sundonin bullgarët. Rreth viteve 1214/1216 Stefan Prvovençani (i Kurorizuari i Parë) e pushtoi Prizrenin, qytet ky që më pastaj, kohë pas kohe hyri nën bullgarët. Gjatë kësaj periudhe, qyteti ishte i mbrojtur nga një fortifikatë dhe disa fortifikata në rrethe të saj. Prizreni ishte qytet i tregëtisë së lirë, rezidencë e ipeshkvit katolik dhe peshkopit bizantin, bullgar dhe serb, si dhe ishte qendër e artit dhe e kulturës.

Kulmin e zhvillimit, Prizreni e arriti gjatë shekullit XIV. Në këtë kohë Prizreni kishte marrë pamje tipike të qyteteve perëndimore mesjetare: *civitas* (qendër administrative e ekonomike) dhe *castrum* apo *castellum* (qytet kala). Sipas përshkrimeve që i bënin udhëpërshkruesit, i ngjante shumë Raguzës (Dubrovnikut). Në të vërtetë, Prizreni gjatë gjysmës së parë të

shekullit XIV, ishte qendër e madhe e kolonistëve raguzanë. Për qëllime të mbrojtjes së interesave, tregtarët raguzanë që vepronin në Prizren, kërkuan që të emërohej një konsull në këtë qytet. Sipas vendimit të Këshillit të Madh Raguzan të datës 8.III.1332, u ngritë konsullata raguzane në Prizren (*quod eius mansio sit in Prisen*). Data e sipërme shënon edhe fillimet e jetës konsullare në Kosovë. Ndërkaq, Prizreni zotëronte eksteritorialitet gjyqësor. Një përvojë e këtillë u përcoll edhe në qytete të tjera të Kosovës, si, në Novobërdë, Trepçë, Prishtinë, Pejë dhe Janjevë. Paralelisht konsullatës në Prizren, raguzanët ngritën edhe disa institucione të tjera, si, doganën, farkëtorën për prerjen e monedhave, kisha dhe spitale. Në këtë qytet është farkuar monedha me mbishkrim "Prisen".

Në gjysmën e dytë të shekullit XIV qyteti filloi të dobësohej për shkak të konflikteve dhe përçarjeve politike. Atëbotë, pas vdekjes së perandorit Dushan (më 1355), qyteti sundohej nga mbreti serb Vukashin (1360-1371), më pastaj pas vdekjes së Vukashinit më 1371, Prizreni u sundua nga princërit arbërorë të familjeve Balshaj dhe Kastrioti. Gjatë gjithë mesjetës në Prizren dhe rrethe janë ngritur monumente të njohura të kultit Romano-Katolik (*Sancta Maria de Prisen* dhe *Sanctus Petrus supra Prisen*)), dhe monumente të kultit Ortodoks Bizantin dhe Serb (Kisha e Zojës Prene-Bogorodica Ljeviška, dhe Manastiri i Shenjtorëve Mihal e Gabriel-Sveti Arhandjeli afër Prizrenit, etj.).



Fig 2.4. Arasta dhe rrethina e saj në fillim të shekullit
(Komuna e Prizrenit, 2002)

Ka të ngjarë se Prizreni disa herë kishte ra nën osmanët. Mirëpo, më 1459, qyteti ra përfundimisht nën administrimin e Perandorisë Osmane ku dhe lulëzoi përsëri. Në shekullin XVI u ndërtuan monumente kulturi të mrekullueshme Osmane si Xhamia e Gazi Mehmet Pashës, Hamami i Gazi Mehmet Pashës, dhe Xhamia e Sinan Pashës. Në atë kohë Prizreni u bë pjesë e provincës Osmane të Rumelisë. Shquhej për qytet tregtar me prosperitet, duke përfituar nga pozita gjeografike dhe rrugëve tregtare në veri-jug dhe lindje-perëndimit që lidheshin mirë me gjithë Perandorinë Osmane. Prizreni u bë qytet më i madh i administratës osmane në Kosovë. Qyteti u pushtua përsëri në fund të shekullit XVII nga Austriakët dhe forcat aleate të tyre. Mirëpo, osmanët shumë shpejt e vunë nën kontroll përsëri.

Prizreni ishte qendër kulturore dhe intelektuale e Kosovës gjatë periudhës Osmane. Ishte e dominuar nga popullata e saj Myslimane, që e përbënin mbi 70% të popullsisë së saj në vitin 1857. Më 1878, në kohën e Lidhjes së Prizrenit, qyteti u bë qendra më e madhe kulturore e shqiptarëve dhe kryeqytet i koordinimit të politikës dhe kulturës së shqiptarëve jo vetëm të Kosovës.



Fig 2.5. Arasta dhe rrethina e saj, 2006

Në shekullin XX qyteti përjetoi një periudhë intensive të ndërimeve rapide posaçërisht në zonat tregtare. Kah fundi i vitit 1918 kur u formua Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene Prizreni u ripushtua dhe hyri nën mbretërinë e porsathemeluar, e cila nga viti 1929 është quajtur Mbretëria e Jugosllavisë. Me decenie të tëra pas instalimit të qeverisjes së egër serbe në Prizren, qyteti në fjalë i bë njëra ndër qendrat e nacionalizmit Shqiptar në luftë për pavarësi.

Prizreni dhe rrethët e saj ishin të prekur në mënyrë të rëndë nga lufta në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Pas përfundimit të luftës në Qershor të vitit 1999 pjesa e madhe e popullsisë shqiptare u kthye në Prizren.

Literatura:

1. John V.A. Fine, Jr., *The Early Medieval Balkans*, dhe 2. *The Late Medieval Balkans*

(botim Ann Arbor, The University of Michigan Press) 1997.

3. Noel Malcolm, *Kosova, një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë 1998

4. Skënder Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI, XVII*, Prishtinë 1982

5. Jahja Drançolli, *Raguzanët në Kosovë, Instituti i Historisë*, Prishtinë 1986, etj.

Përpiloi:

Prof. Dr. Jahja Drançolli, historian



Fig 2.6. Struktura Urbane e Historike e Prizrenit



Fig 2.7. Hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe rrethina në fillimin e shekullit
(Komuna e Prizrenit, 2002)



Fig 2.8. Hamami i Gazi Mehmet Pashës dhe rrethina, 2006



Fig 2.9. Kalaja në fillim të shekullit (Komuna e Prizrenit, 2002)



Fig 2.10.Kalaja, 2006



Fig 2.11. Silueta Urbane e Nënkalasë në fillim të shekullit
(Komuna e Prizrenit, 2002)



Fig 2.12. Silueta Urbane e Nënkalasë, 2006

1.4. KARAKTERISTIKAT E POPULLSISË SË KOSOVËS DHE PRIZRENIT

Numri i popullsisë së Kosovës, përafërsisht është vlerësuar në 1.8 deri në 2.0 milion banorë. Vlerësimi më i saktë duhet të jetë rreth 1.9 milion. Duke u bazuar në Analizat e Standardeve të Vlerësimit të Jetesës në vitin 2000, 88% janë Shqiptarë të Kosovës, popullsia Serbe është llogaritur në 7% përderisa grupet tjera etnike përbëjnë përafërsisht 5 % të totalit të popullsisë. Grupet tjera etnike duke u bazuar në ASVJ kryesisht janë Mysliman/Boshnjak (1.9 %), Romët (1.7 %), dhe Turqit (1 %).




Fig 2.13. Piramida e popullsisë së Kosovës
Burimi: Analizat Socio-Ekonomike dhe Demografike 1999 (SOK)




Fig 2.14. Ndarja etnike në Kosovë në vitin 2000
Burimi: Analizat e Standardeve të Vlerësimit të Jetesës (ASVJ) 2000

Qyteti i Prizrenit është kryeqyteti administrativ i Komunës së Prizrenit, që ka përafërsisht popullatë prej 222,000 banorëve, përfshirë këtu qytetin dhe 76 fshatëra që i përkasin komunës. Pas konfliktit të vitit 1999 përafërsisht 40,000 persona të zhvendosur brenda (PZhB) janë shpërndarë në rajon. Sidoqoftë, rekonstruimi i suksesshëm i më shumë se 10,000 shtëpive krijoi kushte që shumica të kthehen në shtëpitë e tyre (Analiza e Matjes së Standardit të Jetesës, 2000).

Komuna e Prizrenit ka përafërsisht 90% shqiptarë dhe grupe tjera minoritare të boshnjakëve, turqve, rom dhe serbëve. Bazuar në regjistrimin e përgjithshëm të Marsit të vitit 1991 dhe të përpiluar nga Instituti Federativ për Statistika të Jugosllavisë, Komuna e Prizrenit është vlerësuar se ka 175,413 banorë. (Analiza e Matjes së Standardit të Jetesës, 2000).

Shqiptarët, boshnjakët, turqit, romët dhe serbët jetojnë në Prizrenin metropolitan. Edhe pse boshnjakët kosovarë janë grupi kryesor minoritar në terma të statistikave, komuniteti turk kosovar është mjaft i mirënjohur dhe me influence. Turqishtja flitet me të madhe, gjithashtu edhe në mes të Shqiptarëve të Kosovës. Në pjesën veriore të Prizrenit, në regjionin e Podrimës, jetojnë së bashku Shqiptarët dhe Turqit. Në pjesën lindore të Prizrenit, në regjionin e Podgorës së Prizrenit, jetojnë së bashku Shqiptarët dhe Boshnjakët. Në pjesën juglindore gjendet Lugina e Zhupës e cila kryesisht është e banuar me Boshnjak, dhe pjesërisht me Serbë dhe Shqiptarë Kosovarë (Analiza e Matjes së Standardit të Jetesës, 2000).

2.4. KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE TË PRIZRENIT

Ndërmarrjet private në komunë janë të bazuar në agrikulturë, tregti, ndërtimtari dhe prodhimin e të mirave ushqimore. Bizneset private në të shumtën e rasteve kanë vështirësi në sigurimin e investimeve kapitale si nga entitetet lokale ashtu edhe të huaja. Problematikë shtesë është edhe konkurrenca në mes të Shqipërisë, Turqisë dhe Kinës, të cilët e udhëheqin tregun me produktet e importuara, derisa produktet Kineze janë dukshëm më të lira. Për shkak të vuajtjeve financiare, disa kompani dhe fabrika u mbyllën ndërsa të tjerat po reduktojnë numrin e punëtorëve. Kjo rënie e ekonomisë në përgjithësi kontribuon direkt në rritjen e numrit të papunëve dhe varfërisë, duke bërë zbatueshmërinë financiare/ekonomike të parëndësishme në regjion (Profili i Komunës; OSBE, 2006).

Shumë restorante, dyqane me pakicë, dhe bizneset e bazuara në shërbime operojnë në lokale të vogla. Prizreni si duket po mbushet me prosperitetin ekonomik, por këto shfaqje po zbehën pasi që prania ndërkombëtare po zvogëlohet dhe riatdhesimi i refugjatëve pritet që ende të dëmtoj ekonominë lokale. Ngopja e tregut, papunësia e larte dhe reduktimi i dërgimit të mjeteve financuese nga jashtë janë indikatorë ekonomik kërcënues (Profili i Komunës; OSBE,2006)

Në tri fshatra gjenden tri kooperativa bujqësore. Pothuajse i tërë shumimi i bagëtisë dhe produkteve të agrikulturës janë private, informate, dhe me shkallë të vogël. Në Prizren veprojnë tetë banka nëpërmjet degëve të tyre si ProCredit Banka dhe Autoriteti Bankar i Kosovës (BPK), Banka Amerikane e Kosovës (ABK), Banka Private e Biznesit (BPB), Banka e Re e Kosovës (NBK), Kasabanka, Banka Ekonomike, Raiffeisen Banka. Aty janë po ashtu institucionet financiare jo bankare si FINCA dhe KEP (Profili i Komunës; OSBE 2006)

Tani në Komunën e Prizrenit të punësuar janë 21,499 banorë. Prej këtyre 12,371 persona janë të punësuar në sektorin privat, 4,341 persona janë të punësuar në sektorin social, dhe 4,787 persona janë të punësuar në sektorin publik. Shumica e banorëve punojnë në sektorin industrial (41%), tregti me shumicë dhe pakicë (24.6%), shërbime (20%) dhe ndërtimtari (13.4%) (Profili i Komunës; OSBE,2006)

Në sektorin publik në Komunën e Prizrenit më parë ishin 44 ndërtesa industriale dhe kooperativa bujqësore. Këto biznese para konfliktit punësonin një numër prej 15,000 banorëve, ndërsa pas konfliktit ato ishin në gjendje të punësonin vetëm 7,500 njerëz prandaj prodhimet industriale kanë shënuar rënie (Profili i Komunës; OSBE 2006)

Një e dhënë e kalkuluar nga Komuna tregon se 60% të familjeve që jetojnë në viset rurale i derivojnë të ardhurat e tyre nga aktivitetet bujqësore. Sektori i bujqësisë dhe blegtorisë siguron një kontribut të madh në GDP-në në Prizren. Në Komunën e Prizrenit industria primare është bujqësia e kombinuar me agro-industritë e zhvilluara në nivelin lokal. Kjo komunë është e pasur me resurse të shumta bujqësore dhe përgjatë shekujve ka prodhuar lloje të ndryshme të drithërave, rrushit, pemë dhe perime (Profili i Komunës; OSBE,2006).

Komuna e Prizrenit ka potencial të madh në zhvillimin e turizmit, duke u bazuar në pozitën gjeografike, vendndodhjeve tradicionale dhe kushteve klimatike të përshtatshme. Në Komunë përfshihen edhe malet piktoreske të Sharrit, të cilat kanë lartësi që ndryshojnë nga 200 m (Profili i Komunës; OSBE,2006).

2.5. SHËRBIMET SOCIALE, SHËNDETSORE DHE EDUKIMI

Shërbimet sociale, këshille familjare dhe të divorceve, gjithashtu edhe çështjet që kanë të bëjnë me jetimët janë përgjegjësi e Qendrës për Mirëqenie Sociale (QMS). Kjo qendër vepron në bashkëpunim të ngushtë me një OJQ Angleze "Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijë", e cila i administron nevojat e fëmijëve jetim të cilët përkohësisht janë strehuar në një spital lokal. Qendra Sociale siguron paga për njerëzit e pa aftë, të moshuar dhe të ndjeshëm. Një numër i madh i personave me sëmundje kronike nuk kanë për medikamente ose që nuk mundën të mbulojnë shpenzimet e tyre. Refugjatët e kthyer si dhe personat e zhvendosur ballafaqohen me rrethana të vështira, dhe me planin aktual nuk marrin asistencë sociale. Në Komunën e Prizrenit ndodhen 2 vendstrehime me 36 familje refugjatësh. Një komision që do të vlerësojë procesin e rindërtimit të shtëpive të tyre, planifikon që të ndihmon sa më parë kthimin e tyre në vendet e mëparshme (Profili i Komunës; OSBE,2006).

Spitali i Prizrenit ofron shërbime mjekësore për afërsisht 400,000 banorë dhe është spitali i vetëm që mbulon një regjion të gjerë. Në spital të punësuar janë 670 punëtorë duke përfshirë 82 doktorë dhe është i pajisur për emergjencë, njësitë për kujdesin intensiv, dhe autoambulanca që janë donacione nga vende të ndryshme. Po ashtu gjenden edhe 32 shtëpi private shëndetësore dhe laboratorë, 22 ordinanca stomatologjike dhe 19 farmaci, të cilat veprojnë në komunë (Profili i Komunës; OSBE,2006).

Shkollat fillore dhe të mesme në komunë sigurojnë edukim në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke, nëpërmjet planeve të ndryshme mësimore. Komuna ka 40 shkolla fillore dhe pesë të mesme. Në mes tyre janë dy shkolla speciale, njëra për fëmijë me të meta. Po ashtu gjendet edhe dega e Universitetit të Prishtinës, Shkolla e Lartë Pedagogjike. Fakulteti i Edukimit kohë më parë u themelua në Prizren (Profili i Komunës; OSBE,2006).

3. VIZIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË KONZERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Si fazë e parë e studimit, vizioni, qëllimet dhe objektivat e planit të konservimit dhe zhvillimit të Prizrenit janë përcaktuar me anë të një trajtimi bashkëkohorë të çështjes së konservimit dhe planifikimit urban. Këto qëllime dhe objektiva janë parashtruar për urbanizim modern, transport, imperativët reliefor si të qytetit ashtu edhe të pejsazhit, si dhe duke u bazuar në perspektivën e zhvillimit dhe të konservimit që ka kjo zonë.

Duke formuluar përcaktuesit të përgjithshëm të planifikimit, është marrë parasysh edhe struktura e ambientit të Prizrenit me mbështetjen e rigjenerimit ekonomik, duke ruajtur vlerat historike, arkitektonike dhe funksionale. Brenda këtij synimi, objektivat kryesore mund të definojnë si përmirësim i kualitetit funksional, arritjen e një komunikimi optimal, arritjen e integritetit social dhe kulturor, krijimin e një mjedisi pozitiv për kualitetim arkitektonik dhe urban dhe arritjen e optimumin të kushteve për shëndet dhe qetësi, e tëra kjo duke arritur një çmim optimal dhe mbështetje ekonomike gjatë vendimeve të planifikimit, vendime këto fleksibile ashtu edhe të aplikueshme.

3.1. VIZIONI I PLANIFIKIMIT DHE QËLLIMI I PLANIT TË KONZERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË PRIZRENIT

Vizioni i Planit të Konservimit dhe të Zhvillimit mund të promovohet si: "Prizreni: qendra historike, paqësore e multikulturore por kontemporane e Kosovës".

Bazuar në vizionin e mësipërm, qëllimi i Planit të Konservimit dhe Zhvillimit është: "që të formulojë determinantat që mirëmbajnë zhvillim të përshtatshëm modern për strukturën e zonës historike të Prizrenit duke ruajtur vlerat historike, arkitektonike dhe funksionale; si dhe rritjen e planeve të zhvillimit përmes këtyre vendimeve".

3.2. OBJEKTIVAT PLANIFIKUESE TË PLANIT TË KONZERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË PRIZRENIT

Bazuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Aneksi V Art. 4, i Propozimit Gjithëpërfshirës që përcakton Zonat Speciale të Mbrojtura më objektivën e mëposhtme:

“Të sigurohet një ekzistim dhe funksionim paqësor të zonave të mbrojtura; të ruhet mjedisi historik, kulturor dhe natyror, duke përfshirë mënyrën e jetës monastike të klerit; dhe të parandalohet zhvillimi negativ përreth tyre, duke siguruar kushtet më të mira të mundshme për zhvillim harmonik dhe të qëndrueshëm të komuniteteve të cilat banojnë në hapësirat përreth këtyre objekteve”.

Në harmoni me “Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës”, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit përcakton Prizrenin si trashëgimi urbane që posedon numër të madh të objekteve monumentale dhe popullore nga origjina të ndryshme kulturore që duhet të mbrohen. Pasi që diversiteti funksional, kulturor dhe fetar formon pjesën integrale të jetës urbane në Prizren, fuqimisht inkurajohet koekzistenca paqësore e aktiviteteve të ndryshme mbi një hapësirë urbane të përbashkët.

Objektivat planifikuese të Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit janë arritur duke u mbështetur në qëllimet planifikuese të parashikuara si dhe në potencialet e zonës.

Drejt arritjes së qëllimeve specifike këto masa u përvetësuan:

- Vlerësimi i ndërtesave monumentale dhe rrethinën e tyre të tanishme.
- Revitalizimi i vlerave të veçanta për regjionin duke e ruajtur autenticitetin.
- Të punohet në menyrë që të sigurohet vazhdimësia e strukturave historike, civile dhe monumentale të regjionit, dhe të plotësohen nevojat moderne të banorëve.

3.2.1. Kualifikimi Funksional

- Të theksohet roli funksional në relacion me integrimin e zonave tjera fqinje dhe qyteteve tjera të Kosovës,
- Të shfrytëzohen funksionet e reja duke ndërruar karakterin e papërshtatshëm të funksioneve sociale dhe ekonomike në mënyrë

që të sigurohet kontinuiteti i zhvillimit ekonomik përdherisa rruhet edhe modeli urban historik,

- Të krijohet rrjeti i ri i shpërndarjes për shërbimet ekzistuese duke i integruar në arritjet e reja,
- Të sigurohet në funksion mjaftueshmëria dhe efikasiteti i vende si për banorë ashtu edhe vizitorë, duke përmirësuar standardet e jetesës.

3.2.2. Komunikimi Optimal

- Të caktohen rrugët për këmbësorë dhe rrjeti i transportit me automjete në masë të mjaftueshëm për nevojat e zhvillimit të aktiviteteve ekzistuese dhe atyre të propozuara,
- Të lidhen vendet me aktivitete të ndryshme që kanë rëndësi, me hierarkinë për këmbësorë, vendeve të parkimit dhe stacioneve të autobusëve,
- Të sigurohen vendet e parkimit si për banorë ashtu edhe për vizitorë.

3.2.3. Integrimi Social dhe Kulturor

- Të bëhet transformimi i një nga vendet më të rëndësishme të Kosovës përsëri në një qendër atraktive kulturore e turistike, duke lartësuar vlerat kulturore, arkeologjike dhe natyrore, si dhe potencialin e trashëgimisë arkitektonike dhe strukturën tradicionale urbane që e posedon,
- Të ngritët vetëdija publike mbi konservimin e trashëgimisë kulturore duke siguruar një ambient edukativ,
- Të rritë kuptimin e planit të konservimit në mënyrë që të siguroj zhvillimin e strukturave shoqërore,
- Të tërheqë vëmendje në konservim, planifikim dhe procesin e tij të implementimit më pjesëmarrjen e plotë të banorëve.

3.2.4. Mjedis pozitiv për Kualitetin Arkitektonik dhe Urban

- Të promovohet një rrjet mjedisor që vë theks në rolin e ndikimit në cilësinë dhe strukturën urbane, historike, vlerave monumentale

(Kisha e Shën Premtes, Katedralja e Zonjës Ndhimëtare, Xhamia e Gazi Mehmet Pashës , Hamami i Gazi Mehmet Pashës, Xhamia e Sinan Pashës, shtëpitë tradicionale, muret...

- Të përmirësohet kualiteti arkitektonik duke ruajtur, riparuar, ngritur strukturat shkatërruese të papërshtatshme; dhe harmonizimi i tyre në atë shkallë të konsistencës së vendit ku gjinden me arkitekturën bashkëkohore,
- Të krijohen mundësi të reja për banim dhe të formohen strukturat e reja sociale në sensin e konservimit.
- Të ndalohet shkatërrimi i infrastrukturës dhe modelit urban historik dhe të eliminohen pamjaftueshmëritë.
- Të krijohet një imazh i fortë urban, që do të mund të komunikonte me kontinuitetin historik dhe arkitektonik të regjionit të Prizrenit si me banorë ashtu edhe me vizitorë.

3.2.5. Kushtet Pozitive për Shëndet dhe Qetësi

- Të sigurohen kushtet optimale me një kontroll klimatik si në hapësirat e brendshme ashtu edhe të jashtme,
- Të sigurohen kushtet e ndriçimit optimal si në hapësirat e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme duke përdorur ndriçim natyror dhe artificial,
- Të sigurohet pastërtia e mjedisit duke pasur parasysh mbledhjen e mbeturinave dhe vendosjen e kontejnerëve në vende të përshtatshme.

3.2.6. Çmimi Optimal dhe Përkrahja Ekonomike

- Të përdoren resurset e vendit, organizatat e implementimit, vullnetarët dhe ato të njerëzve lokal që të sigurohet çmimi/kualiteti optimal në çdo fazë të planifikimit.
- Të asistohet në gjetjen e resurseve financiare për implementimit.
- Të sigurohen të ardhurat ekonomike në mënyrë që të menaxhohet trashëgimia urbane në jetën e përditshme.

3.2.7. Fleksibiliteti dhe Zbatueshmëria

Të gjinden zgjedhjet fleksibile në mënyrë që të sigurohen rastet e ndryshimit të mëtejme në kohë dhe hapësirë.

4. STUDIMI DHE ANALIZAT E ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit, janë bërë vlerësime analitike duke i ri-bërë dhe plotësuar analizat ekzistuese dhe duke bërë analiza shtesë. Analizat fizike janë bërë si në bllokun e ndërtesave ashtu edhe në nivelin e ndërtesave individuale. Struktura urbane është analizuar me shqyrtimin e hapësirave dhe objekteve individuale. Ndërsa për analizat sociale janë kryer po ashtu vlerësimet analitike të cilat janë specifike dhe përmbajnë strukturën demografike, relacionet shfrytëzues-ndërtesë / relacionet në mes të ambientit fizik, komunikimet sociale dhe nivelet e bashkëveprimit, opinione për konservimin urban si dhe për zonën e planifikimit.



Fig 4.1. Pamje e Përgjithshme e Zonës Historike të Prizrenit




Fig 4.2. Kufijtë e Zonës Historike të Prizrenit



Fig 4.3. Silueta e Përgjithshme e Zonës Historike të Prizrenit



Fig 4.4. Siluetat e Zonës Historike të Prizrenit



Legjenda

- Monument i evidentuar
- Ndërtesë qytetare e evidentuar
- Zonë e ndërtuar
- Zonë e pandërtuar



Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
Prof.Dr. Nuran Zaman GJERDEZI, Dr. Blegji EYİBOĞU, Turgay Karim KORAMAL, Fikri ABACIAR, Prof.Dr. Seyyap AKOĞAR, (Shërbime)

**CH
WB** Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN




Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 4.5. Harta e zonave të ndërtuara dhe të pandërtuara

4.1. MODELI I TRANSPORTIT NË ZONEN HISTORIKE TË PRIZRENIT

Analizat e transportit përfshijnë rrugët për automjete, rrugët e ndaluara për automjete, këmbësorët dhe vendet për parkim. Që të dy rrugët si ato për automjete ashtu edhe ato për këmbësorë janë kontrolluar brenda kapacitetit të tyre shfrytëzues, kontinuitetit të rrjedhës dhe gjerësitë e rrugëve.



Legjenda

	Monument i evidentuar		Rrugë për automjete me mbingarkesë
	Ndërtesë qytetare e evidentuar		Rrugë për automjete me ngarkesë
	Ngazira objektsh		Drejtimi i automjeteve
	Rrugë		Shteg për këmbësorë
	Parkingje		Rrugë me ndalim qarkullimi për automjete



Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Prof. Dr. Nuran Jovan GÖRGEN, Dr. Ergin EYİBOĞAZ, Nurgül Karam KIRANAK, Pinar ASACILAR, Prof. Dr. Zeynep ARINBAK, (Konservim)

CH
WB Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN



Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 4.6. Harta e modelit të Transportit në Zonën Historike të Prizrenit

4.2. ANALIZA E OBJEKTEVE DHE HAPËSIRAVE INDIVIDUALE

Cilësitë urbane janë shqyrtuara me analiza të objekteve dhe hapësirave individuale sikurse përdorimi i pronës dhe eobjekteve, gjendja e objektit, etazhiteti i objektit, konstruksioni i objektit, shfrytëzimi i bjektit, harmonia me karakterin arkitektonik të zonës. Vlerat kulturore dhe strukturat do të konsiderohen me status të objekti të listuar në ngastër dhe objekteve monumentale në zonën e studimit.

4.2.1. Përdorimi i Pronës dhe Objektit

Tabela 4.1. Përdorimi i Pronës dhe Objektit – Përdhësja

Përdorimi i përdhësës	No. i Objekteve	%
Banim	685	42,81
Komercial – Tregëti	169	10,56
Shërbime komerciale	60	3,75
Kulturore Turistike Komerciale	112	7,00
Hotel	3	0,19
Banim i Pashfrytëzuar	134	8,38
Komerciale e Pashfrytëzuar	46	2,88
Gërmadha	178	11,13
Ndërtim	28	1,75
Parking	22	1,38
Shërbime Publike	21	1,31
Shërbime Kuturore	5	0,31
Shërbim Arsimi	10	0,63
Objekt Fetar	24	1,50
Shërbim Shëndetësor	14	0,88
Zyre - Bankë	33	2,06
Depo	36	2,25
Zanate	20	1,25
Gjithsej	1600	100,00






Tabela 4.2. Përdorimi i Pronës dhe Objektit – Kati i sipërm

Përdorimi i Katede të mësipërme	No. of Buildings	%
Banim	710	67,43
Komercial – Tregëti	17	1,61
Shërbime komerciale	4	0,38
Kulturore Turistike Komerciale	30	2,85
Hotel	3	0,28
Banim i Pashfrytëzuar	131	12,44
Komerciale e Pashfrytëzuar	10	0,95
Gërmadha	35	3,32
Ndërtim	24	2,28
Shërbime Publike	12	1,14
Shërbime Kuturore	3	0,28
Shërbime Arsimi	7	0,66
Objekt Fetar	11	1,04
Shërbim Shëndetësor	6	0,57
Zyre - Bankë	24	2,28
Depo	24	2,28
Zanate	2	0,19
Gjithsej	1053	100,00





Legjenda

	Monument i evidentuar		Shërbime kulturore dhe turistike		Shërbime publike		Zyra-Banka
	Ndërtesë qytetare e evidentuar		Hotel		Shërbime kulturore		Depo
	Banim		Banim i pashfrytëzuar		Shërbime animore		Objekte prodhimi
	Tregëti		Tregëti e pashfrytëzuar		Objekte kulti		Ndërtime të reja
	Shërbime tregtare		Gërmadha		Shërbime shëndetësore		Parkingje



Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Prof. Dr. Nevan Jovan GÜZERİOĞLU, Dr. Ergin YİĞİTÖĞLÜ, Turgay Karim KIRANNAZ, Pinar ARACILAR, Prof. Dr. Jeynep ARKINBAŞI (Korollanet)

**CH
WB** Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN



Istanbul Technical
University
TURKEY


Fig 4.7. Harta e Shfrytëzimit të Objekteve dhe Hapësirave Individuale në përdheshë

Me cilësitë e saj urbane dhe karakteristikat arkitektonike, Qyteti i Prizrenit karakterizohet me minaret, tyrbet (mauzoleumet), fontanat, Hamamet, shtëpitë e ulëta njëkatëshe ose dykatëshe dhe rrugët e saja të ngushta . Kulmet me çeremide të kuqe janë karakteristike tjetër peisazhit urban. Në kontekstin urban hapësira historike-komerciale Shadërvani është qartë e ndarë nga hapësirat e banimit.

Shtëpitë tradicionale të qytetit e vjetër së bashku me objektet teresore kanë oborr të rrethuar. Ato janë të ndërtuara nga druri dhe guri. Na paraqiten shumë homogjene, me dy ose tre kate etazhitet.



Fig 4.8. Objektet për banim



Legjenda

	Monument i evidentuar		Shërbime kulturore dhe turistike		Shërbime publike		Zyra-Banka
	Ndërtesë qytetare e evidentuar		Hotel		Shërbime kulturore		Depo
	Banim		Banim i pashfrytëzuar		Shërbime animore		Objekte prodhimi
	Tregëti		Tregëti e pashfrytëzuar		Objekte kult		Ndërtime të reja
	Shërbime tregtare		Gërmadha		Shërbime shëndetësore		



Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
Prof.Dr. Nuran JARAN GÜZERSOY, Dr. Engin EYİBOĞA, Sargay Karam KÖRANNAZ, Pinar ASACILAR, Prof.Dr. Zeynep ARUNBAT (KastellBosna)

CH
WB
Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN



Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 4.9. Harta e Shfrytëzimit të Objekteve dhe Hapësirave Individuale në katin e mësipërm



Fig 4.10. Objektet fetare

Objektet tradicionale zakonisht kanë përdhesën dhe katin e mësipërm të ndërtuar në mënyrë simetrike. Përdhesa zakonisht përmban kuzhinat dhe disa dhoma. Shtëpitë janë të lyera me pigmente ngjyrë të bardhë os engjyra natyrale të kaltër apo okër. Enterieri i shtëpive përmban pak ose asnjë mobile. Ato zakonisht përmbajnë dollape të ndërtuara brenda mureve si dhe rafte nga panele druri. Dhoma kryesore kanë hamamxhikun.




Fig 4.11. Objektet komerciale

4.2.2. Gjendja e Objekteve

Tabela 4.3. Gjendja e objekteve

Gjendaj e Objekteve	Nr.i objekteve	%
Shumë e mirë	354	22,13
E mirë	463	28,94
Mesatare	451	28,19
E keqe	152	9,50
E shkatërruar	180	11,25
Gjithsej	1600	100,00




Analiza e kushteve objekteve është formuluar në pesë nivele të evaluimit. Objekti në gjendje shumë të mire i referohet objekteve të reja ose të renovuara. Pastaj shkalla e dytë i referohet objekteve në gjendje të mire që ka të bëjë me gjendje strukturore. Objektet në gjendje mesatare janë ato që nuk kanë mirëmbajtje apo rindërtim.

Objektet në gjendje të keqe kërkojnë mirëmbajtje urgjente apo restaurim. Në të kundërtën objektet e shkatërruara janë ato të cilat kanë humbje strukturale apo në gjendje gërmadhe.

Shumica e objekteve të betonit të ndërtuara vonë e që janë në kundërshti me stilin tradicional janë në gjendje të mire. Shumica e objekteve në gjendje të keqe dhe të shkatërruar janë në zonën e Nënkalasë dhe në pjesën jugorë të Zonës Historike të Prizrenit. Ekzistojnë objektet monumentale që kanë nevojë urgjente për restaurim (sikurse Kisha Shën Shpëtimtari, Kishe e Shën Gjergjit, etj.)



Fig 4.12. Objektet dhe gjendja e tyre



Legjenda

 Shumë e mirë	 E mirë	 Mesatare	 E keqe	 E Shkatëruar
 Monument i evidentuar	 Ndërtësë qytetare e evidentuar			



Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
Prof.Dr. Nuran Jaziri GÜZEROT, Dr. Engin EYERÖĞÜ, Turgay Karim KÖRANAZ, Pinar ABACILAR, Prof.Dr. Seyyap ARGINBAŞ (Korshinëve)

CH
WB Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN




Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 4.13. Harta e Gjendjes së Objekteve

4.2.3. Etazhiteti i objekteve

Tabela 4.4. Etazhiteti i objekteve

Etazhiteti	Nr. i objekteve	%
1 kat	547	34,19
2 kate	733	45,81
3 kate	271	16,94
4 kate	42	2,63
5 kate	6	0,38
6< kate	1	0,06
Gjithsej	1600	100,00



Në analizën e etazhiteti të objekteve është vërejtur që përqindja e madhe e objekteve kanë 1 ose 2 kate.

Objektet monumentale, lartësia e të cilave ndryshon apo kalon 3 katet, janë supozuar me lartësitë e tyre relative bazuar në lartësitë e zakonshme të etazhave.




Fig 4.14. Objektet dhe etazhiteti i tyre

4.2.4. Materialet Ndërtimore të Objekteve

Tabela 4.5. Materialet Ndërtimore të Objekteve

Materiali	Nr. i objekteve	%
Beton	1064	66,50
Mure massive (çerpiç)	484	30,25
Hekur	1	0,06
Dru	1	0,06
Pa informata	50	3,13
Gjithsej	1600	100,00



Analiza e materialeve ndërtimore tek objektet dëshmojnë se shumica e strukturave të ndërtuara janë nga betoni.


Shtëpitë tradicionale janë më së shpeshti të ndërtuara me teknikë muresh massive (çerpiç).

Egzistojnë shumë shëpi të tradicionale dhe objekte komerciale me teknikë të mureve masive që janë në harmoni me karakteristikat autentike arkitektonike.

Shtëpitë janë të ngjyrosura me ngjyrë të bardhë ose pigmente të ngjyrës së kaltër apo okeri.



Fig 4.16. Objektet dhe materialet e tyre ndërtimore



Legjenda

 Beton	 Mure masive (çerpiç)
 Dru	 Monument i evidentuar
	 Ndërtesë qytetare e evidentuar



Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Prof. Dr. Neran Dreni GÜLERDÖY, Dr. Ergül EYİBOĞAZ, Turqay Karam KOKARMAZ, Pinar ARACILAR, Prof. Dr. Zeynep AKINERAT, (koordinator)

CH
WB

Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN




Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 4.17. Harta e Materialve Ndërtimore të Objekteve

4.2.5. Shfrytëzimi i Objekteve

Tabela 4.6. Shfrytëzimi i Objekteve

Shfrytëzimi i Objekteve	Nr. i objekteve	%
Të shfrytëzuara	1172	73,25
Pjesërisht të shfrytëzuara	61	3,81
Të pashfrytëzuara	367	22,94
Gjithsej	1600	100,00



Objektet e zonës tradicionale tregtare dhe të banimit janë kryesisht të shfrytëzuara.

Në zonën tradicionale tregtare egzitojnë disa shembuj e objekteve të gjysëmshfrytëzuara ku përdhessa e tyre përdoret për shërbime turistike dhe ato të tregëtisë.

Shumica e objekteve të zbrazëta në zonë në një gjendje qe të keqe duhet të përfundohen dhe të përdoren për çfarëdo qëllimi.



Fig 4.18. Objektet dhe gjendja e tyre e shfrytëzimit



Legjenda

 Të shfrytëzuar	 Monument i evidentuar
 Pjesërisht të shfrytëzuar	 Ndertesë qytetare e evidentuar
 Të pashfrytëzuar	



Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
Prof. Dr. Naim Zaim GÖRBOĞI, Dr. Ingin EYİBOĞU, Turqy Karam KÖRMAZ, Pinar ARACILAR, Prof. Dr. Zeynep AYUBAY, (Korridor)

**CH
WB** Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN




Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 4.19. Harta e Shfrytëzimit të objekteve

4.2.6. Harmonia me karakterin Arkitektonik të Zonës

Tabela 4.7. Harmonia me Karakterin Arkitektonik të Zonës

Harmonia me Karakterin Arkitektonik të Zonës	Nr. i objekteve	%
Në harmoni	1045	27,00
Në dis-harmoni	502	70,00
Pa informata	53	3,00
Gjithsej	1600	100,00




Materialet ndërtimore, objektet, lartësia, raporti i homogjenitetit të fasadave dhe karakteristikat tjera fizike të të gjitha objekteve janë evaluar duke respektuar konsistencën e karakterit arkitektonik dhe strukturës urbvane të zonës, duke injoruar përshtatshmërinë e tyre funksionale.

Në kuadër të këtij evaluimi, objektet në zonën e konzervuar janë evaluar nëse ato mbrojnë apo janë në harmoni me karakteristikat strukturale, vizele dhe arkitektonike. Për objektet tradicionale harmonia është evaluar bazuar në atë nëse ka shtesa apo strukturale, apo nëse kanë ndryshime të mëdha nëpër fasada, dritare, hyre dhe elemente tjera vizuale. Objektet tjera të reja që janë konsideruar nëpërmjet kësaj analize është ajo nëse këto janë me proporcione apo shkallë të përafërt në kuzadër të vëllimit të objekteve apo tipeve të fasadave.

Objektet tradicionale të cilat duhet të ruhen si arkitekturë qytetare janë në rrezik të humbjes nga arsyet që kanë të bëjnë me intervenim dhe rindërtime të objekteve.



Fig 4.20. Objektet në harmoni



Legjenda

 Në harmoni	 Monument i evidentuar
 Në dis-harmoni	 Ndërtesë qytetare e evidentuar



Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZENIT

Prof. Dr. Naim Zekri GJERDECI, Dr. Bujar DIBROÇI, Turgut Karim KOBARALI, Piro ABACILAR, Prof. Dr. Zeynep AKINBAŞI (Shqipëri)

CH
WB Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN



Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 4.21. Harta e Harmonisë me Karakterin Arkitektonik të Zonës


Egzistojnë shumë objekte të reja nga betoni sidomos në pjesën perëndimore dhe veriore të zonës. Intervenimi më i shpeshtë në shembuj të objekteve të arkitekturës qytetare është ndëlimi i shtesave të reja në kuadër të pronës private. Njësitë e objekteve tradicionale për tregëti mund të kenë ndryshime në krahasim me përdorimin e tyre original.



Fig 4.22. Disharmonia e objekteve

4.2.7. Objektet Monumentale

Kisha e Shën Premtes



Kisha e Shën Premtes e cila gjendet në Listën Botërore të Trashëgimisë është njëra nga kishat më të rëndësishme e mbijetuar në tërë rajonin duke paraqitur njërin nga shembujt më të mirë të arkitekturës së Bizanit të Vonshëm kudo (Kosovo Mission Report, 2006).

E ndërtuar me urdhër të Mbretit Serb Milutin, kisha është ndërtuar më 1306-7. Kisha pesë-kupollëshe është e inkorporuar në mbetjet e bazilikës Bizantine 3 anijatëshe nga shekulli XI, e rimodeluar pjesërisht në shek. XIII.

Duke filluar që nga 1019 nën sundimin Bizantin kisha shërbeu si katedrale e Prizrenit, funksion të cilin e mbajti gjatë shek.XIII sikurse dhe gjatë shek.XIV të rimodelimit serb. Si e tillë, është e vetmja kishë katedrale urbane serbe që ka mbijetuar. Megjithatë ambienti rrethues fizik i kishës ndryshon gjatë shekujve në vijim, objekte të vogla private rrethojnë strukturën deri në ditët e vona (Krasniqi, 2002).

Katedralja e Kishës së Shën Gjergjit



Katedralja e Shën Gjergjit gjendet në qendrën e vjetër urbane të Prizrenit, në kuadër të zones së quajtur Shadërvan e banuar tradicioanlisht nga popullata Serbe (Kosovo Mission Report, 2006).

Kjo Kishë e madhe Ortodokse Serbe e Prizrenit është ndërtuar dhe dekoruar mes viteve 1856 dhe 1887. Ndërtimi i saj përkajë Xhamive Islamike dhe Kishës Katolike (të gjithë në afërsi të bllokut nga njëri tjetri) tregojnë llojllojshmërinë etnike dhe fetare që kanë karakterizuar Prizrenin që nga Mesjeta. Kisha paraqet një objekt të madh me kombinim të karakteristikave të bazilikës në skemë të kryqit.

Kisha i përket kompleksit i cili përfshin poashtu një kishë të dedikuar Shën Gjergjit (e njohur si Kisha e Runoviqëve). Ky objekt i vogël piktoresk duhet të ketë kaluar në dy faza të ndërtimit (shek. 14 dhe 16). Kisha posedon afreska interesante nga shek.16 pastrimi i të cilave ka filluar në 1995 dhe mbeti e pambaruar më 1999. Kompleksi poashtu përfshin objekte të banimit dhe zyre të lidhura me selinë e Kishës së Rashkës-Prizrenit (Kosovo Mission Report, 2006).

Kisha e Shën Shpëtimtarit




Kisha e Shën Shpëtimtarit dominon pjesën veriore të qytetit të Prizrenit "Nënkalaja" e banuar tradicionalisht me serbë. Në 1999 një pjesë e Nënkalasë ishte shkatërruar dhe djegur, kur komuniteti serb e lëshoi lagjen. (Krasniqi, 2002).

Në mars 2004, pjesa e mbetur e zonës së banuar urbane u shkatërrua dhe monumenti u djeg dhe u dëmtua seriozisht.

Kompleksi i kishës përbëhet nga dy pjesë të rëndësishme arkitektonike. Kisha e vjetër ishte ndërtuar rreth 1330 në formën e kryqit grek të atrofizuar me kupollë dhe narteks. Fasada e saj është e formësuar me alternime të gurit dhe të tullave dhe shirita llaçi me përdorim të gjërë të elementeve decorative të terrakotës. Afresakt e faltores datojnë nga mesi i shek. XIV. Në 1836 është hartuar një projekt për kupollë më të madhe të gurit, mirëpo muret e larta së bashku me këmbanoren mbeten ende. Më 1882 kisha u kaplua nga zjarri që rezultoi me dëmtime të mëtutjeshme. Kisha vazhdoi të jetë në shërbim për festa fetare deri më 1999 (Kosovo Mission Report, 2006).

Xhamia e Sinan Pashës



Xhamia e Sinan Pashës, sipas mbishkrimit të saj është ndërtuar me 1615. Arkitektura e saj shprehë fuqi, kompaktësi, hir dhe elegancë. Sa i përket tipit arkitektonik paraqet raritet të artit islamik. Bazuar në pozitën e saj, elegancën, karakteristikat masive dhe minares së saj të hijshme dominon në peisazhin e qytetit. Kupolla e saj e madhe është e përshtatur në mënyrë harmonike në masën katrore të objektit. Xhamia është e pozicionuar në nivel të lartë duke pasur pamje në rrugën kryesore të qytetit historik. Me kupollën e saj gjigande dhe minaren e saj elegante përbën njërin nga elementet dominante të karakteristikave arkitektonike të Prizneit. (Kosovo Mission Report, 2006).

Enterieri i xhamisë është e dekoruar me dizajne gjeometrike, ende të mbijetuara si dhe me tapiceri përderisa pjesët tjera të mureve janë janë ngjyrosur në ngjyra të forta.


Medresa e cila e i përkiste xhamisë kishte planimetri katrore 14 x 14m e mbuluar me kupollë me hapësirë mihrabi të projektuar 4,1 x 4,5m të mbuluar me gjysëm kupollë. Kupollë është e mbështetur në mure trashësia e të cilëve është 1,65m. Xhamia ende përmban dyhemenë e saj origjinale të gurit, dekorimet në enterier, në podium si dhe punë të ndryshme të drurit mirëpo të cilat kanë nevojë për restaurim (Rexha, 2004).

Xhamia e Gazi Mehmet Pashës



Xhamia e Gazi Mehmet Pashës është monument më i vjetër i artit islamik në Prizren. Mbishkrimi mbi hyrje shënon se ajo është ndërtuar me 1561. Xhamia ka bazë katrore dhe shumë dritare, përderisa mihrabi dhe mimberi janë të ndërtuara nga mermeri. Mauzoleumi heksagonal (medresa) është e ndërtuar në oborr të xhamisë ku Mehmet Pasha e rezervoi vendin për varrin e tij (İbrahimgil, and Konuk, 2006).

The Fort Prizren



Kalaja është e ndërtuar mbi gurë natyror. Në kohërat e lashta ka qenë e shfrytëzuar si bastion ushtarak. Në afërsi të saj janë zbuluar vendbanime të kohës së Neolitit si dhe qeramike dhe armë ilire (Krasniqi, 2002).

Gjatë periudhës Romake, qyteti origjinal ilir i Therandës zhvillohet si garnizon përreth Kalasë. Gjatë periudhës Osmane ka qenë e shfrytëzuar në vazhdimësi. Gjatë sundimit të Mehmet Pashës (1809-36) ka qenë e ndërtuar një sahat-kullë ndërsa më 1828 është ndërtuar një xhami. Ka mundësi që objekti së pari është ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. XV pas pushtimit të Prizrenit nga Osmanët më 1455. Më 1912, pas marrjes së Prizrenit nga armata serbe, kalaja dhe të gjitha objektet tjera u shkatërruan (Rexha, 2004).

Gazi Mehmet Pasha's Bath



Hamami i Prirenit është monument i periudhës së hershme Osmane ku gërshetohen traditat orientale dhe lokale. Hamami është themeluar nga Gazi Mehmet Pasha, sanxhakbeji i Shkodrës më 1573-4 bashkarisht me ansamblet arkitektonike të shquara që e formojnë (İbrahimgil, and Konuk, 2006).

Kompleksin ku është vendosur Hamami përfshinë xhaminë me kupollë të madhe që më vonë nisi të quhet si Xhamia e Bajraklisë, shkollë mesme (medresa), shkolla fillore (mejtepi), biblioteka dhe mauzoleumin (tyrben) e themeluesit. Të gjitha këto objekte ende ekzistojnë sot. Hamami gjendet 150 m larg nga xhamia.

Objekti është hamam i dyfishtë: gjysma për meshkuj dhe gjysma tjetër për femra që kanë poashtu edhe hyrje të veçantë. Posedon hapësira të njejta të brendshme: hapësira për zhveshje, hapësira e nxehtë, hapësira e nxehur me dhoma të ndryshme të vogla për larje. Hapësira e nxehur është e mbuluar me qemerë dhe kupolla të vogla të mbuluar nga plumbi, përderisa hapësira për zhveshje është e mbuluar me kupollë me tjegulla. Objekti është i ndërtuar nga gurët “çakëll” dhe çimento. Pjesët e brendshme të mureve janë të suvatosura. Sot, objekti përdoret si muze (Rexha, 2004).

Muzeu i Lidhjes Shqiptare te Prizrenit



Në qendër të qytetit, buzë Lumbardhit gjendet shtëpia ku më 1878 është organizuar Lidhja e Prizrenit. Ky ka qenë kuvendi i të gjithë përfaqësuesve shqiptarë të rajonit ku dhe shtëpia sot posedon arkiva me shumë dokumente për Lidhjen e Prizrenit (Kosovo Mission Report, 2006).



Xhamia e Sinan Pashës



Kisha e Shën Gjergjit



Teqja e Halveti



Xhamia e Gazi Mehmet Pashës



Kisha e Shën Shpëtimtarit



Shkolla fillore "Lidhja e Prizrenit"



Hamami i Gazi Mehmet Pashës



Katedrala e Zonjës Ndhimtare



Muzeu



Xhamia e Haxhi Ramadanit



Kisha e Shën Premtes



Komuna



Shembull i arkitekturës qytetare



Shembull i arkitekturës qytetare



Shembull i arkitekturës qytetare

Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
Prof.Dr. Neran Jovan GJERGJIT, Dr. Ergut DYRBOGJIT, Turgut Karam KURBAN, Fitor ABASÇI, Prof.Dr. Zeynep KIRIMAY, (Bosiljević)

CH
WB
Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN

Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 4.23. Objektet Monumentale




Fig 4.24. Harta e Objekteve Monumentale

4.3. ANALIZA E STRUKTURËS SOCIALE

Sa i përket analizës sociale, evaluimi analitik është përcaktuar nga struktura demografike, raporti shfrytëzues – objekt/hapësirë fizike, niveli i bashkëveprimit social dhe opinioni përreth konservimit urban në zonën e planifikimit.



Fig 4.25. Njësitë tradicionale të banimit dhe karakteri urban i Zonës Historike të Prizrenit.



Fig 4.26. Hapësirat urbane të hapura buzë lumit.

4.3.1. Struktura demografike

Tabela 4.8. Madhësia e familjes

Madhësia e familjes	Nr. i personave	%
1-2 persona	11	11,00
3-4 persona	36	37,00
5-6 persona	37	38,00
7~	14	14,00
Gjithsej	98	100,00





Tabela 4.9. Moshë e nënës

Moshë e nënës	Nr. i personave	%
~20	5	4,00
21-30	6	5,00
31-40	29	22,00
41-50	27	21,00
51~	63	48,00
Total	130	100,00



Analiza e structures sociale tregon se shumica e familjeve në zonën historike kanë më shumë se një fëmijë. Pas rezultateve të pyetësorëve, përqindja e familjeve 5-6 anëtarësghe dhe 3-4 anëtarëshe janë më dominante në zone. Numri i familjeve 3-4 anëtarëshe është 37% ndërsa i familjeve 5-6 anëtarëshe është 38%.

Rezultati i analizës për moshën e nënave tregon se shumica e nënave në zonë janë më të vjetra se 30 vjet. Numri më i madh është ajo e nënave me mbi 51 vjet që është 48%.

62% të nënave në familje janë të lindura në Prizren (80 sosh). Shumica e nënave që jetojnë në Prizren kurrë nuk e kanë ndëruar vendin e banimit. Ka disa arsye për këtë situatë. Është gjendja ekonomike e populates dhe fakti se nuk kanë gjendje të mire materiale për ndërrim të vendbanimit. Arsyeja e dytë është se shumica e njerëzve janë të kënaqur me ambientin e tyre të jetesës.

Tabela 4.10. Arsimimi i nënës

Arsimimi	Nr. i personave	%
Pa arsimim	32	25,00
Shkrim lexim	47	36,00
Arsimin fillor	0	0,00
Arsimim i lartë	38	29,00
Arsimim universitar	13	10,00
Gjithsej	130	100,00





Tabela 4.11. Profesionit i nënës

Occupation	Nr. i personave	%
Amvisë	101	76,00
Të pensionuar	10	8,00
Studente	4	3,00
Udhëheqës dyqani	1	1,00
Presantuese	1	1,00
Motër medicinale	3	2,00
Doktor	1	1,00
Punëtore	5	4,00
Farmaciste	1	1,00
Zyrtare	1	1,00
Mësuese	3	2,00
E vetëpunësuar	1	1,00
Gjithsej	130	100,00



Në familjet e analizuara, nënat zakonisht kanë nivel të ndryshëm të edukimit. Shumica e nënave kanë edukim fillestar (36,47%). Numri i nënave që nuk kanë pasur kurrfarë niveli të arsimimit në jetën e tyre është mjaft i madh (%25, 32).

Në përgjithësi personat e moshës më të vjetër që jetojnë në zone kanë arsimin më të ulët se të rinjtë.

Amviset përbëjnë 76% të nënave të intervistuar (67 persona). Niveli i dytë më i lartë është i përbërë nga nënat e pensionuara në gjithsej 10 persona (8%).

Tabela 4.12. Të ardhurat e nënës

Të ardhurat	Nr. i personave	%
Pa të ardhura	82	61,00
~50 Euro	26	20,00
100-150	13	10,00
160-200	3	2,00
210~ Euro	2	2,00
Fondi social	5	4,00
Pa përgjigje	1	1,00
Gjithsej	130	100,00





Tabela 4.13. Moshë e babait

Moshë e babait	Nr. i personave	%
~20	1	1,00
21-30	3	3,00
31-40	20	21,00
41-50	27	28,00
51~	45	47,00
Gjithsej	96	100,00



Përderisa shumica e nënave të intervistuar janë amvise, ato nuk kanë të ardhura vetanake. Si rezultat, shumica e nënave nuk kanë ët ardhura. Numri është 61% nga totali. Për arsye se të ardhurat e pensionistëve janë 40 euro, niveli i dytë më i lartë i grupit të të ardhurave është më pak se 50 euro. Rezultate të njejta i atribuohen në objekte të listuara dhe të palistuar. Një pikë tjetër e shquar është se 4 % e totalit të nënave marrin të ardhura nga fondi social.

Përqindja e baballarëve me moshë mbi 50 vjet është 47%. Në zone baballarët që janë me moshë nën 30 vjet përbëjnë një grup të vogël. Shënimet e përqindjeve rreth vendit të lindjes së janë të njejta me atë të nënave. 60% e baballarëve të intervistuar janë të lindur në Prizren. The rate of people born in Prizren is even more than the total number of fathers born in various different cities.

Tabela 4.14. Arsimimi i babait

Arsimimi	Nr. i personave	%
Pa arsimim	7	7,00
Shkrim lexim	25	26,00
Arsimin fillor	0	0,00
Arsimim i lartë	40	42,00
Arsimim universitar	24	25,00
Gjithsej	96	100,00





Tabela 4.15. Profesionimi i babait

Profesioni	Nr. i personave	%
I pensionuar	24	25,00
Mjek	2	2,00
Punëtor	14	14,00
Ushtar	2	2,00
Moler	1	1,00
Pronar dyqani	1	1,00
Zyrtar	3	3,00
Mësues	2	2,00
I vetëpunësuar	7	7,00
Zejtari	3	3,00
Ndërtimtar	3	3,00
Shofer	3	3,00
Kopshtar	1	1,00
Artist	1	1,00
Turizëm	1	1,00
I papunësuar	29	31,00
Gjithsej	96	100,00



Rezultati i arsimimit të baballarëve tregon se ata kanë nivel të arsimimit më të lartë se nënat në zonë. Përderisa 24% e nënave nuk kanë pasur kurrë asnjë lloj arsimimi ky numër bie në 7% tek baabllarët. Përqindja e baballarëve të cilët kanë diplomuar në shkollim të lartë përbën pjesën më të madhe analizës së edukimit e që është 42%. Baballarët që kanë diplomuar në universitet kanë përafërsisht vlerë të njëjtë me ata që kanë vetëm shkrim-lexim.

Sipas pyetësorëve, niveli më i lartë me vlerë 31% përbëhet prej baballarëve të papunësuar. Njëra prej pikave që vlen të përmendet është edhe niveli i lartë i papunësisë. Përqindja e baballarëve që janë të pensionuar është poashtu e lartë (25%).

Tabela 4.16. Të ardhurat e babait

Income	Nr. i personave	%
Pa të ardhura	26	28,00
~50 Euro	24	25,00
100-150	15	15,00
160-200	10	10,00
210~ Euro	13	13,00
Fondi Social	7	7,00
Pa përgjigje	2	2,00
Gjithsej	96	100,00





Tabela 4.17. Pronësia e veturës

Pronësia e veturës	Nr. i personave	%
Biçikletë	19	19,00
Automjet	42	43,00
Tjera	37	38,00
Gjithsej	98	100,00




Ndërlidhur me përqindjen e lartë të papunësisë të paraqitur në analizën e profesioni të babait, përqindja e baballarëve të cilët nuk kanë të ardhura është 28% në përgjithësi. Duke marrë parasysh të ardhurat e nënave, baballarët kanë të ardhura më të mëdha. Gjithsej numri i baballarëve që fitojnë më shumë se 210 euro në muaj është 13% përderisa kjo shifër vlen vetëm për 2% të nënave.

Në analizë, pronësia e veturave është marrë si indikacion i gjendjes ekonomike të familjes. Përqindja e familjeve që posedojnë vetura është 43%. Në objektet e listuara 45% të familjeve dhe në objektet e palistuara 28% të familjeve posedojnë veturë. Qytetarët e Prizrenit zakonisht preferojnë të ecin për arsye të gjendjes ekonomike. Numri i shfrytëzuesve të biçikletave është poashtu i lartë.

4.3.2. Relacioni shfrytëzuesi-objekti

Tabela 4.18. Pronësia

Pronësia	Nr. i personave	%
Pa pagesë	34	35,00
Me qira	2	2,00
Pronar	62	63,00
Gjithsej	120	100,00



Në 98 intervista të realizuara është konfirmuar se 63% e njerëzve të intervistuar janë pronarë të shtëpive të tyre. Pronarët e shtëpive jetojnë një kohë të gjatë në të njëjtin vend. Shumica e njerëzve e kanë të trashëguar shtëpinë nga prindërit e tyre.

Tabela 4.19. Periudha e banimit

Koha	Nr. i personave	%
1-5 Vjet	18	18,00
6-10 Vjet	19	19,00
11-20 Vjet	1	1,00
21-30 Vjet	3	3,00
31+	57	59,00
Gjithsej	98	100,00




Tabela 4.20. Lokacioni i mëparshëm

Lokacioni	Nr. i personave	%
Në komunë të njëjtë	44	45,00
Në Prizren	23	23,00
Jashtë Prizrenit	28	29,00
Jashtë vendit	2	2,00
Pa përgjigje	1	1,00
Gjithsej	98	100,00





Tabela 4.21. Karakteristikat e shtëpisë së kaluar

Karakteristikat e shtëpisë	Nr. i personave	%
Objekt i vjetër (masiv)	50	51,00
Apartament nga betoni	4	4,00
Shtëpi nga betoni	7	7,00
Pa përgjigje	37	38,00
Gjithsej	98	100,00



Analiza e pyetjes sa i përket periudhës së jetesës në të njëjtën shtëpi tregon se më shumë se gjysa e familjeve jeton në të njëjtin vend qe 30 vite. Ky numër paraqet 59% të totalit të personave të përfshirë në pyetësor

Shqyrtimet e lokacionit të lokacionit të banimit të mëhershëm tregon se shumica e familjeve kanë jetuar në komunë të njëjtë. Përqindja e njerëzve të cilët më herët kanë jetuar në Prizren ose jashtë saj është përafërsisht e njëjtë. Ata të cilët kanë jetuar në Prizren janë 23%, përderisa ata të cilët kanë jetuar jashtë saj janë 29%.

Shumica e familjeve të intervistuar nuk kanë dhënë përgjigje në pyetjen sa i përket karakteristikave të shtëpisë së kaluar që kanë jetuar.

Prej tyre që kanë dhënë përgjigje shumica e njerëzve të intervistuar kanë jetuar në objekte të vjetra (masive). Numri i përdorimit të këtyre objekteve është 51% nga totali/

Tabela 4.22. Dëshira për ndërrim (jetesë) në një shtëpi tjetër

Dëshira për ndërrim	Nr. i personave	%
Po	31	31,00
Jo	67	67,00
Pa përgjigje	2	2,00
Gjithsej	98	100,00




Tabela 4.23. Lokacioni i dëshiruar për ndërrim

Lokacioni i dëshiruar	Nr. i personave	%
Jashtë Prizrenit	14	14,00
Komunë e njëjtë	1	1,00
Komunë tjetër	15	15,00
Pa përgjigje	68	70,00
Gjithsej	98	100,00





Tabela 4.24. Tipi i banimit të preferuar

Tipi i banimit të preferuar	Nr. i personave	%
Objekt i vjetër (masiv)		
Apartament betoni	4	4
Shtëpi betoni	31	32
Pa përgjigje	63	64
Gjithsej	98	100



67% të banorëve nuk konsiderojnë që të jetojnë në një shtëpi tjetër. Ka arsye të ndryshme për këtë rezultat. Shumica prej tyre nuk kanë fuqi ekonomike për ndërrim të vendit të banimit. Disa prej tyre janë të kënaqur me shtëpitë e tyre ndërsa disa nuk konsiderojnë ta ndërrojnë vendin e jetesës sepse vetë janë pronarë të shtëpisë.

30% e njerëzve do të kishin dëshirë të jetojnë në një lokacion tjetër nga Prizrenit. Nga ky 30% shgumica e familjeve preferojnë të jetojnë jashtë Prizrenit dhe atë në 14%. Ata të cilët dëshirojnë të jetojnë në komunë të njëjtë përbëjnë gruin më të vogël dhe atë 1%.

64% të të intervistuarve nuk i janë përgjigjur pyetjes në lidhje me shtëpinë e banimit që do të preferonin nëse do ta ndërronin vendbanimin. 32% nga 36% i deklaruar thonë se do të dëshironin të jetonin në shtëpi banimi individual të betonit në vend të asaj që jetojnë sot. Kjo për arsye se shumica e tyre jetojnë në shtëpi të vjetra.

Tabela 4.25 Plotësimi i nevojave me shtëpinë (niveli i kënaqësisë)

Niveli i kënaqësisë	Nr. i personave	%
Po	32	33,00
Jo	66	67,00
Gjithsej	98	100,00




Tabela 4.25. Dëshira për përmirësim të shtëpisë

Dëshira për përmirësim të shtëpisë	Nr. i personave	%
Po	27	28,00
Jo	71	72,00
Gjithsej	98	100,00





Tabela 4.26. Preferencat për intervenim

Preferenca e përdorimit	Nr. i personave	%
Përdorim pas restaurimit	23	23,00
Objekt i ri	49	51,00
Riparim	3	3,00
Pa përgjigje	23	23,00
Gjithsej	98	100,00



Si indikator i nivelit të kënaqësisë me shtëpi, banorët janë pyetur nëse shëpia i plotëson nevojat e tyre. Duke marrë parasysh se shumica e tyre jetojnë nëpër të njëjtat shtëpi kohë të gjatë dhe vjetërsia e objekteve është evidente, shumica e tyre mendojnë se kushtet në shtëpitë e tyre nuk janë të mjaftueshme. 67% prej tyre deklaruan se nuk janë të kënaqur me gjendjen e shtëpive.

Familjet të cilat janë pyetur nëse janë të interesuar për çfarëdo ndryshimi në shtëpi të tyre shumica janë përgjigjur se nuk kanë plan për të bërë ndonjë ndryshim. Vetëm 28% e tyre do të dëshironin të bënin ndonjë riparim në shtëpitë e tyre.

Arsyeja kryesore që ndalon njerëzit të bëjnë ndryshime është prapë gjendja ekonomike e familjes.

Njerëzit që jetojnë në objekte jo të listuara preferojnë të kenë shtëpi të reja në vend të restaurimit të objektit që posedojnë. Numri i atyre njerëzve që kanë dëshirë të kenë shtëpi të re në rast se ka fonde të mjaftueshme është 51%.

4.3.3. Nivelet sociale të Komunikim-Bashkëveprimit

Tabela 4.27. Të afërmit tjerë në Prizren

Kanë të afërm në Prizren	Nr. i personave	%
Po, kanë	49	38,00
Jo, nuk kanë	75	59,00
Pa përgjigje	4	3,00
Gjithsej	98	100,00




Tabela 4.28. Raporti i bashkëveprimit me fqinjë

Raporti i bashkëveprimit me fqinjë	Nr. i personave	%
Nuk kanë	1	1,00
Shumë	97	99,00
Gjithsej	98	100,00





Tabela 4.29. Raporte të afërta me fqinjë

Cordial Relationship	Nr. i personave	%
Yes	93	95,00
No	5	5,00
Gjithsej	98	100,00



Si indikator i nivelit të komunikimit social, të intervistuarit janë pyetur nëse kanë të afërm të tjerë në Prizren apo jo. 38% e tyre kanë të afërm që jetojnë në distance të vogël, përderisa 59% e tyre nuk kanë asnjë ët afërm.

Bazuar në të intervistuarit 99% e familjeve janë të kënaqur me raport të bashkëveprimit me fqinjë. Ky nivel rritet në 100% tek objektet e jo listuara.

95% e familjeve të intervistuar raportuan se janë bashkëveprues dhe kanë raporte të afërta me fqinjët e tyre. Njerëzit që jetojnë në objekte jo të listuara konsiderojnë se nuk kanë raporte të afërta mes fqinjëve dhe atë në 12%. Ky numër bie në 3% tek njerëzit që jetojnë në objekte të listuara.

Tabela 4.30. Hapësirat e përbashkëta për takime të lagjes

Hapësirat e përbashkëta	Nr. i personave	%
Po, ekzistojnë	9	9,00
Jo, nuk ekzistojnë	89	89,00
Gjithsej	98	100,00




Tabela 4.31. Dëshira për pjesëmarrje në zbukurim të lagjes me fqinjët

Dëshira për pjesëmarrje	Nr. i personave	%
Po, dëshirojnë	97	99,00
Jo, nuk dëshirojnë	1	1,00
Gjithsej	98	100,00





Tabela 4.32. Dëshira për pjesëmarrje në zbukurim të lagjes me ndonjë organizatë

Dëshira për pjesëmarrje	Nr. i personave	%
Po, dëshirojnë	97	99,00
Jo, nuk dëshirojnë	1	1,00
Gjithsej	98	100,00



89% e të intervistuarve deklaruan se nuk ka hapësira të përshtatshme për banorë të lagjes.

Sa i përket kësaj, ankesat më të mëdha kanë të bëjnë me mungesën e hapësirave për parkingje, hapësira për lojë të fëmijëve, hapësira për këmbësorë, shërbime kulturore, tregje të hapura dhe parqe të qytetit.


99% e të intervistuarve shprehin vullnetin për pjesëmarrje në zbukurim të lagjes së bashku me fqinjët e tyre. Ekziston një dallim i vogël në ideja nga njerëzit që jetojnë në objekte të listuara në krahasim me ato të palistuar.

Rezultatet e pyetjes sa i përket pjesëmarrjes së zbukurimit të lagjes nëpërmjet ndonjë organizate janë të njejta me ato të cialt shprehin vullnet për pjesëmarrje në zbukurim të lagjes së bashku me fqinjë.

4.3.4. Evaluimi i Hapësirës Fizike

Tabela 4.33. A jeni të kënaqur me shërbimet komunale ?

A jeni të kënaqur me shërbimet komunale ?	Nr. i personave	%
Po	2	2,00
Jo	96	98,00
Gjithsej	98	100,00




Banorët e objekteve të listuara dhe pothuajse të gjithë banorët e objekteve të palistuara nuk janë të kënaqur me shërbimet komunale. 98% e tyre konsiderojnë se nuk janë të kënaqur me komunën.

4.3.5. Opinion i banorëve sa i përket Konzervimit Urban

Tabela 4.34. Perceptimi i banorëve për Konzervimin e Prizrenit


Perceptimi për konservim të Prizrenit	Nr. i personave	%
Po	94	96,00
Jo		
Pa përgjigje	4	4,00



Familjet të cilat janë pyetur nëse konservimi i qytetit të Prizrenit paraqet rëndësi i janë përgjigjur me po dhe atë në 96% të rasteve. Ky është indikator i rëndësishëm sa i përket vetëdijësimit të njerëzve për trashëgimi kulturore.

Tabela 4.35. Perceptimi i banorëve sa i përket ndërrimit të objekti të listuar me objekt të ri shumëkatësh

Objektet shumëkatëshe do ta zbkuronin zonën	Nr. i personave	%
Po, do ta zbkuronin		
Jo, nuk do ta zbkuronin	98	100,00
Gjithsej	98	100,00



Të gjithë pjesëmarrësit e intervistës mendojnë se zëvendësimi i objekteve të listuara me objekte shumëkatëshe do të dëmtonte ambientin historik të qytetit.

Ideja e përgjithshme e njerëzve është që të vlerësohen tiparet historike të zonës me anë të organizimeve të ndryshme në Prizren. Shumica e njerëzve kanë deklaruar se ata e imagjinojnë vendin të shfrytëzohet për qëllime turistike dhe mendojnë se shumica e shtëpive të listuar duhet të restaurohen dhe të shfrytëzohen si hotele, restorante dhe përmbajtje të ngjashme. Njerëzit kanë nevojë për një mjedis me më shumë vende për këmbësorë dhe se Prizreni duhet të zhvillohet duke marrë parasysh potencialin turistik dhe kulturor.



Fig 4.27. Jeta shoqërore në Prizren

5. EVALUIMI DHE VENDIMET PLANIFIKUESE NË PLANIN E KONSERVIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Prizreni është një ndër vendet me rëndësi historike në Kosovë, që ka një strukturë urbane e cila vlen të ruhet. Ka të mbetura arkitektonike dhe monumentale të cilat kanë rëndësi historike, estetike dhe perspective arkitekturale. Ruajtja e kësaj strukture për gjeneratat e ardhshme është përgjegjësi globale kur bëhet fjalë për integrimin social dhe kulturor. Vendimet planifikuese janë përcaktuar brenda strukturës së asaj përgjegjësie të definuar edhe në objektivat planifikuese.

Grupi i Planifikimit ka vlerësuar të gjitha të dhënat të mbledhura në terren duke u bazuar në qëllimet dhe objektivat e projektit dhe kanë zhvilluar vendimet planifikuese nga ky set i informatave.

Konservimi i këtij vendi është i ndarë në tetë zona duke u bazuar në analizat dhe karakteristikat kryesore të tyre. Kriteri kryesor për propozim qëndron në katër titujt kryesorë si:

- Funksionale,
- Fizike,
- Historike (Kulturore),
- Transporti.

Konkluzionet që dolën nga këto analiza janë përshkruar në formë të shkruar dhe në formë grafike, si dhe në shtesa të direktivave të projektit urban për karakteristikat dhe propozimet mbi strukturën, dukjet, pamjes së rrugës dhe pamjes së qytetit brenda zonës së planifikimit.

Në këtë fazë, vendimet janë zhvilluar gjithashtu për mënyrën e projektimit dhe janë bërë rekomandime për restaurimin e objekteve monumentale, intervenimet në arkitekturën qytetare, ndërtimeve të reja dhe aplikacionet tjera përmbushëse që do të ruajnë karakteristikat urbane dhe arkitektonike. Ky është një plan i konservimit urban që do të ruajë dhe vlerëson funksionalitetin në përputhje me strukturën totale urbane përderisa të mosshkatërroj esencën e karakterit.

5.1. EVALUIMI I STUDIMIT DHE FORMULIMI I KRITEREVE PËR PROJEKTIM

Evaluimi dhe vendimet për planifikim të planit të konservimit të Prizrenit fillon duke formuluar kriteret për projektim. Me revizimin e vendimeve të mëhershme për planifikim, janë marrë vendimet të përgjithshme për planifikim dhe projektim.

Propozimet dhe intervenimet gjithashtu janë zhvilluar në nivel ndërtesash, të cilat janë vendosur në databazë dhe formatin GIS. Databaza përmban listen e blloqeve / numrin e ngastrës të vlerësuar për secilën strukturë ekzistuese krahas edhe propozimit për ndërtimet e ardhshme. Databaza e ndërtesave përfshinë karakteristikat ekzistuese dhe të propozuara për secilën ndërtesë /njësi.


Kryesisht në studim janë përdorur shkallët 1/2000, dhe 1/1000, për skemat dhe diagramet që janë përdorur për zhvillimin e vendimeve mbi strukturën fizike të Prizrenit. Kriteret kryesore për propozime mbështeten mbi funksionin (karakteristikat e shfrytëzimit të tokës, shërbimet urbane/publike, edukimin, shëndetësinë, administrata, rekreacioni etj), gjendjen fizike, historike (arkitektura monumentale dhe qytetare), transportit (qarkullimi i automjeteve dhe këmbësorëve, vendet për parkim). Për vizualizimin e vendimeve dhe propozimeve për planin e konservimit, intervenimet do të merren parasysh në shkallën e pamjes së qytetit dhe pamjes së rrugëve. Me revizimin e vendimeve të mëhershme të planifikimit, vendimet e reja janë marrë duke u bazuar në analizat (problemet dhe potencialet) dhe janë adaptuar kriteret për konservim dhe zhvillim.

Tabela 5.1. Databaza e objekteve të gjeneruara në GIS

Burimi	Përdhesa	Katet	Etazhileti	Gjendja	Materiali	Shfrytëzueshmëria	Harmonia	Pr
Vend-ndodhje	Kulturor turistik tregtar	Kulturor turistik tregtar	3	Shumë e mirë	Beton	E shfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Zyrë-bankë	Zyrë-bankë	2	E mirë	Mure masive	Pjesërisht E shfrytëzuar	Në harmoni	
Vend-ndodhje	Zyrë-bankë	Zyrë-bankë	2	E mirë	Mure masive	Pjesërisht E shfrytëzuar	Në harmoni	
Vend-ndodhje	Zyrë-bankë	Zyrë-bankë	2	E mirë	Mure masive	Pjesërisht E shfrytëzuar	Në harmoni	
Vend-ndodhje	Zyrë-bankë	Zyrë-bankë	3	E mirë	Beton	E shfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Kulturor turistik tregtar	Banim i pashfrytëzueshëm	4	Mesatare	Beton	E pashfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Kulturor turistik tregtar	Banim	4	E mirë	Beton	E shfrytëzuar	Në harmoni	
Vend-ndodhje	Kulturor turistik tregtar	Banim i pashfrytëzueshëm	4	E keqe	Beton	Pjesërisht E shfrytëzuar	Në harmoni	
Vend-ndodhje	Kulturor turistik tregtar	Banim	Lartësia	Mesatare	Beton	Pjesërisht E shfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Gërmadha	Gërmadha	3	Gërmadha	Mure masive	E pashfrytëzuar	Në harmoni	
Vend-ndodhje	Kulturor turistik tregtar	Depo	2	Shumë e mirë	Mure masive	E shfrytëzuar	Në harmoni	
Vend-ndodhje	Tregti-me pakicë	Banim	2	Mesatare	Mure masive	E shfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Kulturor turistik tregtar	Banim i pashfrytëzueshëm	2	E keqe	Mure masive	Pjesërisht E shfrytëzuar	Në harmoni	
Vend-ndodhje	Tregti-me pakicë	Banim i pashfrytëzueshëm	2	E mirë	Beton	Pjesërisht E shfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Kulturor turistik tregtar	Kulturor turistik tregtar	2	E mirë	Beton	E shfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Tregti-me pakicë	-	1	E mirë	Beton	E shfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Tregti-me pakicë	-	1	E mirë	Beton	E shfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Tregti-me pakicë	Depo	2	E mirë	Beton	E shfrytëzuar	Në dis-harmoni	
Vend-ndodhje	Tregti-me pakicë	Banim i pashfrytëzueshëm	2	E mirë	Mure masive	Pjesërisht E shfrytëzuar	Në harmoni	


Tabela 5.2. Databaza e Ndërtesave duke pasur parasysh Strukturën e Listuar dhe Ndërtesat Tjera

building no		EXISTING						
5		ground floor	upper floor	height	condition	material	occupancy	harmony
		Office - Bank	Office - Bank	3	Good	Concrete	Occupied	Disharmony
		PROPOSAL						
		intervention	building use	height				

building no		EXISTING						
6		ground floor	upper floor	height	condition	material	occupancy	harmony
		Cultural Touristic Commercial	Unoccupied Housing	4	Average	Concrete	Unoccupied	Disharmony
		PROPOSAL						
		intervention	building use	height				

building no		EXISTING						
7		ground floor	upper floor	height	condition	material	occupancy	harmony
		Cultural Touristic Commercial	Housing	4	Good	Concrete	Occupied	In Harmony
		PROPOSAL						
		intervention	building use	height				

building no		EXISTING							
8		ground floor	upper floor	height	condition	material	occupancy	harmony	
		Cultural Touristic Commercial	Unoccupied Housing	4	Bad	Concrete	Partly Occupied	In Harmony	
		PROPOSAL							
		intervention	building use	height					
		LISTED BUILDING							
		TEOLOGICAL SCHOOL BOGOSLLOVIA							
		Period of Construction	Under the Protection	Valuation	Evidential				
		1871			•				



Legjenda

- | | | | |
|------------|--|-------------|--|
| I | Zona tradicionale e dyqaneve | VI | Zona e shfrytëzimit të përzier dhe banimit |
| II | Zona e blloqeve të ndërtesave të larta | VII | Zona organike e banimit |
| III | Zona e bregut të lumit | VIII | Zona e banimit sipas trendeve aktuale të ndërtimit |
| IV | Zona e nën-kalasë | | |
| V | Zona e aksit të dyqaneve | | |



Plani i konservimit dhe zhvillimit të ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT


Prof. Dr. Nuran Sarvan GÜRSÖY, Dr. Engh YËRBOĞUL, Turqay Karim KÖRRAZ, Pinar ABACILAR, Prof. Dr. Skjerp ARUNBAT, (KorinBosna)

CH
WB Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN




Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 5.1. Planifikimi i Zonave duke u bazuar ne Evaluimin e Studimit



VLERËSIMI 2006



VLERËSIMI 2006



I Zona tradicionale të dyqaneve



V Zona e aksit të dyqaneve



III Zona e bloqeve të ndërtesave të larta



VI Zona e shfrytëzimit të përzier dhe banimit



III Zona e bregut të lumit



VII Zona organike e banimit



IV Zona e nën-kalasë



VIII Zona e banimit sipas trendeve aktuale të ndërtimit



Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Prof. Dr. Nuran Jelen GÜLİRGÖY, Dr. Engin EYİBOĞU, Tugay Karim KIZILBAZ, Pinar ABACI, Prof. Dr. Zeynep AKOĞUT (KoriliBosna)

CH
WB Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN

Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 5.2. Revidimi i Planifikimit të Zonave me Studimet paraprake planifikuese



Fig 5.3.a. Karakteristikat e Planifikimit të Zonave me Potencial, Probleme dhe Propozime

	MUNDËSITË	PROBLEMI	PROPOZIMI
 V Commercial Axe Zone Zona e aksit të dyqaneve	FUNKSIONALE Shërbime tregtare dhe tregti me pakicë		Shërbime tregtare Tregti me pakicë
	FIZIKE Shërbime tradicionale tregtare Objekt e ambient për tregti me pakicë		
	HISTORIKE Hamami i Gazi Mehmet Pashës		Restaurimi i Hamamit të Gazi Mehmet Pashës dhe rrethinës së tij
	TRANSPORTI Qarkullim i madh i automjeteve dhe këmbësorëve	Trotuar i ngushtë për gjatë rrugës	Ri-shtrimi dhe zgjerimi i trotuareve
 VI Mixed Use and Housing Zona e shfrytëzimit të përzier dhe banimit	FUNKSIONALE Shfrytëzim i përzier Qendër kulturore Kinema e hapur	Punëtori prodhimi dhe riparimi	Tregti/banim Qendër kulturore/kinema e hapur
	FIZIKE Kisha e Shën Premtes Hamami me Sahatkullën Xhamia e Haxhi Ramadanit	Dendësi e madhe në trendin e ndërtimeve banuese Arkitektura qytetare në gjendje të keqe	Kontroll mbi kualitetin e objekteve të reja midis haësirave të lira dhe objektit Restaurimi i objekteve monumentale dhe rrethinës së tyre
	HISTORIKE	Pamjaftueshmëri e izolimit të këmbësorëve Mungesë parkingjesh	Ri-rregullimi i qarkullimit të automjeteve Parkingje
	TRANSPORTI		
 VII Housing Zone (Organic Pattern) Zona organike e banimit	FUNKSIONALE Zonë banimi	Mungesë e hapësirave të lira urbane	Banim Parqe urbane Shesh lojërash
	FIZIKE Strukturë organike e rrugëve	Objekte në dis-harmoni me pejsazhin	Kontroll mbi ndërtimet e reja
	HISTORIKE Arkitekturë qytetare Në harmoni me strukturën urbane	Objektet e reja në dis-harmoni me strukturën urbane	Restaurimi i arkitekturës qytetare
	TRANSPORTI	Mungesë e lidhjeve të rrugëve dhe vazhdimësisë	Ri-rregullimi i sistemit të transportit
 VIII Housing Zone (In Construction Trend) Zona e banimit sipas trendeve aktuale të ndërtimit	FUNKSIONALE Shërbime arsimore dhe shëndetësore		Shërbime arsimore dhe shëndetësore Banim
	FIZIKE Katedralja e Zonjës Ndihmëtare Shkolla fillore "Lidhja e Prizrenit"	Dendësi e madhe e trendeve të ndërtimeve banuese nga qytetarët me të ardhura të larta	Kontroll mbi kualitetin e objekteve të reja midis haësirave të lira dhe objektit
	HISTORIKE	Arkitektura qytetare në gjendje të keqe	Restaurimi i monumenteve dhe rrethinës së tyre
	TRANSPORTI	Pamjaftueshmëri e izolimit të këmbësorëve Mungesë parkingjesh	Ri-rregullimi i qarkullimit të automjeteve Parkingje

Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT
Prof.Dr. Nuran Sezen GÜBERGÖY, Dr. Ergül YILBOĞUÇ, Turqije Kanem KÖRANKAL, Pinar ABAOGLAR, Prof.Dr. Jeynep ARINÇAY (Zhvillerues)

CHWB Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN

ISTANBUL TECHNICAL UNIVERSITY
TURKEY

Fig 4.3.b. Karakteristikat e Planifikimit të Zonave me Potencial, Probleme dhe Propozime

5.2. PLANI PRELIMINAR I DIZAJNIT

Skema gjenerale e planit është zhvilluar duke u bazuar në propozimet për planifikim në tetë nën-zonat. Skema e propozimeve është detajuar në titujt si funksioni, gjendja fizike, kulturë dhe transport. Brenda planit të zhvillimit propozimet kanë të bëjnë me banim, tregti- aktivitete të përziera, shërbime shoqërore dhe kulturore, dhe transporti.




Fig 5.4. Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit

Tabela 5.3. Propozimi për Distribimin e Tokës dhe Shfrytëzimit të Ndërtesave

Funksionet	m2	%
Banimi	148 650	36.74%
Densiteti I ulët	55 550	
Densiteti mesatar	93 100	
Banim+Tregti	69 110	17.08%
Tregti	10 000	2.47%
Edukim	6 900	1.71%
Kulturë	12 950	3.20%
Hotel	18 500	4.57%
Nënkalaja	12 600	
Tirana	2 300	
Campung?	3 600	
Shëndetësia	1 650	0.41%
Religjioni	18 215	4.50%
Administratë	7 120	1.76%
Park	9 100	2.25%
Transporti	86 505	21.38%
Rrugët (Automjete)	31 890	
Rrugët (Shërbime)	7 950	
Rrugët këmbësorie	46 665	
Lumi	15 900	3.93%
Gjithsej	404 600	100,00%

Tabela 5.4. Vendimet e Planifikimit

VENDIMET PËR FUNKSIONIN

Akomodimi dhe banimi

Shërbimet komerciale, kulturore dhe turistike në katin përdhese.

Shërbimet komerciale dhe tregti me pakicë në harmoni me shkallën dhe madhësinë e shfrytëzimit të tokës/pronës urbane.

Decentralizimi i aktivitetëve prodhuese dhe komerciale që janë në disharmoni me modelin tradicional.

Njohja e shfrytëzimit të objektit në objektet monumentale të lira.

Shërbimet e Hapura për Rekreacion.

Shërbimet edukativo kulturore si muze dhe qendër kulturore.

Ndërtesat e administrimit publik

Shërbimet edukative dhe shëndetësore.

VENDIMET MBI GJENDJEN FIZIKE

Ndërtimi i llojeve të ndërtesave në harmoni me arkitekturën tradicionale me karakteristika si ato të përditshme, neoklasike, komerciale dhe tipit të ndërtesave qytetare.

Ndërtimi i ndërtesave në harmoni me formën dhe madhësinë e modelit urban.

Rregullimi i pamjes së qytetit dhe elementeve të peizazhit në harmoni me arkitekturën tradicionale.

Disejnim i orendive urbane dhe rrugës së shtruar në harmoni me pamjen tradicionale të qytetit.

VENDIMET PËR KONSERVIM

Restaurimi i objekteve monumentale

Ruajtja e modelit tradicional urban

Rinovimi i fasadave me pjesën e përparme që i përket siluetës tradicionale.

Rekonstruktimi i ndërtesave të rrënuara sipas siluetës tradicionale.

Ndërtimi i ndërtesave të reja që janë në harmoni me formën dhe madhësinë e rrethit

VENDIMET PËR TRANSPORTIN

Rirregullimi i qarkullimit optimal të automjeteve

Rregullimi i shërbimeve rrugore për zvogëlimin e qarkullimit të automjeteve.

Shfrytëzimi i zonës së tregtisë dhe rrethit të saj vetëm nga këmbësorët.

Ndarja e qarkullimeve të automjeteve nga ato këmbësorie.

Organizimi i vend parkingjeve në zonat që janë në shërbim të pjesës tregtare.

Rrugët e shtruara në mënyrë tradicionale në harmoni me pamjen e qytetit.

5.2.1. Vendimet në Lidhje me Banim

Zonat e Banimit janë të vendosura në të dy anët , veriore dhe jugore, të gjirit të ngushtë të Lumëbardhit. Në pjesën veriore zonat e banimit janë propozuar me blloqe ndërtesash me lartësi nga 3 kate (P+2). Blloqet e ndërtesave, ku lokalet komerciale janë zënë me modelin e shfrytëzimit të ndryshëm, janë rregulluar si tip I ndërtesave të bashkangjitura.

Zona e Banimit, në pjesën jugore është e propozuar me lartësi prej 3 kateve (P+2). Zona e banimit (ne modelin organik), nëpërmjet pjerrtësisë, është e rregulluar me llojin e ndërtesave të veçuara. Në modelin ekzistues urban mbulimi me ndërtesa sillet prej 40% në 60%. Për tërë Zonën Historike të Prizrenit, arkitektura monumentale dhe qytetare është shqyrtuar më lartësitë e objekteve dhe zonën e veprimit të tyre.




Fig 5.5. Zonat e Banimit në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit

5.2.2. Vendimet në Lidhje me Tregtinë- Aktivitetet e Përdorimit të Përzier

Zhvillimet komerciale brenda tërë zones historike është riaranzhuar me përdorimit mikes të integruar me kuarte banimi. Aktivitetet e vogla dhe të mesme janë të inkurajuara në këto zona.

Pjesa jugore e zonës dhe blloqet që janë përball rrugës Ismet Kumanova dhe Gjirit të ngushtë të Lumëbardhit janë propozuar si shfrytëzim i përzier (banim – tregti dhe banim – zyre) në lartësi prej 4 kateve. Blloqet me shfrytëzim të përzier janë rregulluar si tip i ndërtesave të bashkangjitura. Gjithashtu në zonat e shfrytëzimit të përzier arkitektura monumentale dhe qytetarë është shqyrtuar me lartësitë e ndërtesave dhe zonën e veprimit të tyre/




Fig 5.6. Zonat e Shfrytëzimit të Përzier në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit

Janë dy vende të cilat janë të rregulluara për qëllime komerciale dhe për zyra, vende këto që i përshtaten shfrytëzimit urban edhe ne gjendjen ekzistuese. Njëra është në veri te Shatërvanit dhe tjetra gjendet në bllokun e ndërtesave të larta përballë rrugës Adem Jashari. Blloku i ndërtesave përballë rrugës Adem Jashari është definitivisht në disharmoni me strukturën urbane dhe peisazhin. Kjo pjesë është planifikuar si “projekt individual hapësinor” me mbulim të objektit në nivel 2.00 që do të përdorej për akomodim, zyra, shërbime tregtare, banke dhe tregti me pakicë, kafene, restorant si dhe shërbime sociale kulturore si kinema, teatër dhe sallë për ekspozita.




Fig 5.7. Zonat e Shfrytëzimit Tregtar , të Zyrave në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit

Aktivitetet dëmtoese apo penguese në shkallë dhe tip të prodhimit janë ndaluar sidomos përreth objekteve monumentale. Punëtoritë e vogla / të mesme jodëmtoese mund të funksionojnë përderisa kanë leje nga autoritet komunale apo legjislative. Punëtoritë e mëdha mekanike dhe funksionet industriale, apo edhe pompat e benzinës janë të ndaluara reptësisht brenda zones historike.

5.2.3. Vendimet në Lidhje me Shërbimet Sociale dhe Kulturore

Ne Zonën Historike Të Prizrenit janë paraparë shërbimet shoqërore dhe kulturore, arsimore, shëndetësore, objekte religjioze dhe parqet e urbanizuara.

Shërbimet Arsimore

Në zonën e planifikimit gjindet vetëm një shkollë fillore, shkolla e mjekësisë dhe shkolla e muzikës.

Shërbimet Shëndetësore

Vetëm një spital gjendet në pjesën juglindore të zonës së planifikimit.




Fig 5.8. Shërbimet Sociale dhe kulturore në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit.

Shërbimet Sociale dhe Kulturore

1. Kompleksi I Lidhjes Shqiptare të Prizrenit
2. Hamami i Gazi Mehmet Pashës,
3. Qendra Kulturore Xhemajl Berisha,
4. Teqja Halveti,
5. Kinema e Hapur.

Si plotësim i këtyre shërbimeve, oborri i ndërtesës së sindikatës është propozuar të shfrytëzohet për festivale të hapura. Shkolla e teologjisë, sahat kulla dhe hamami janë propozuar për librari, muze dhe shërbime tjera kulturore.

Shërbimet Administrative

Komuna e Prizrenit është zhvendosur nga pjesa lindore e Lidhjes së Prizrenit në një objekt modern në pjesën perëndimore. Objekti i Sindikatës gjithashtu mund të shfrytëzohet si objekt i komunës që shfrytëzohet për studime rreth konservimit dhe studio të ndryshme.

Objektet Religjioze

Të gjitha objektet religjioze (7 xhami dhe 6 kisha) janë ruajtur përbrenda planit.

Parqet Urbane

Shërbimet më të mjaftueshme janë ato shërbime sociale dhe vendet të lojërave. 10 sheshe të lojërave dhe parku janë paraparë në parcelat e pa ndërtuara në mes të blloqev e të banimit.

5.2.4. Vendimet lidhur me Transportin

Veriu i zonës së planifikimit ka rrjedhë të trafikut më të dendur. Por në pjesën jugore qarkullimi i transportit ka me pak qasje për shkak të pjerrësirav e të larta topografike dhe rrugëve të ngushta. Duke u bazuar në problemet e qasjes së transportin qarkullimi i automjeteve është i propozuar në bazë të limitev e të qarkullimit. Në zonën e tregut tradicional rrugët këmbësorike dhe rrugët shërbyese janë të rregulluara në mënyrë që ti shërbejnë funksionit kulturor dhe turistik.

Parkimi i automjeteve

Problemet tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me transportin e Prizrenit janë mungesa e vendeve të caktuara për parkim. Në mungesë të rrugëve e të gjëra dhe sipërfaqeve të hapura (të pa ndërtuara), është e vështirë të rregullohet organizimi i i hapësirave për parkim të automjeteve. Në plan parkimi anësor dhe parkimi nëntokësor është propozuar që të shërbej në zhvillimin e mundshëm të aktiv iteteve komerciale dhe turistike.




Fig 5.9. Sistemi i Transportit në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit

Public Transportation System

Sot, transporti publik nuk ekziston. Unaza e transportit publik është propozuar që ti shërbejë posaçërisht çarshisë tradicionale dhe shërbimeve turistike. Shërbimet e transportit publik mund të aranzhohen me autobusët e vegjël ekologjik apo tramvajet dhe atë në harmoni me strukturën urbane tradicionale .



Fig 5.10. Sistemi i Transportit Masiv në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Prizreni

5.3. PROJEKTI

Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit është i detajuar në tetë nën-zona për ti përcaktuar strategjitë e planifikimit.



Fig 5.11. Tetë Zonat e Planifikimit të Zonës Historike të Prizrenit

Vendimet e planifikimit janë caktuar në bazë të titujve si vendimet që kanë të bëjnë me funksionin, gjendjen fizike, konservimin dhe transportin. Në vendimet që kanë të bëjnë me funksionin janë marrë parasysh karakteristikat urbane dhe arkitektonike. Janë ruajtur funksionet që janë në harmoni dhe që përshtaten me aktivitetet kulturore-turistike dhe komerciale. Funksionet si depot dhe aktivitetet prodhuese janë decentralizuar në drejtim të jashtëm të zonës historike.


Vendimet mbi gjendjen fizike janë diskutuar që të rehabilitohen, reviatlizohen dhe harmonizohen lagjet urbane me karakterin tradicional urban. Gjithashtu për secilën zonë, ndërtimi i llojeve të ndryshme të objekteve definohet si lloj i bashkangjitur apo i veçuar varësisht prej specifikës së ndërtesës, densitetit dhe lartësisë.

Vendimet që kanë të bëjnë me konservimin, si restaurimi i objekteve monumentale, ruajtja e modelit urban tradicional, riparimi i fasadave ballore duke iu përmbajtur siluetës, rindërtimi i objekteve të shkatërruara duke u bazuar në siluetën ekzistuese tradicionale, ndërtimi i ndërtesave të reja në harmoni me madhësinë dhe formën e rrethinës, janë përcaktuar duke pasur parasysh hapësirat që ndodhen.

Vendimet që kanë të bëjnë me transportin kryesisht e trajtojnë rregullimin e rrugëve të automjeteve dhe këmbësorëve në kontekst të ndarjes së qarkullimit të automjeteve nga këmbësorët dhe organizimin e optimumit të zonave për parkim të automjeteve.

I. ZONA E TREGUT TRADICIONAL

H38

	FUNKSIONI	Kati përdhes shfrytëzohet për shërbime komerciale, kulturore dhe turistike. Në katin e sipërm pension dhe hotel. Prodhimtarie tradicionale (endje e qilimit, qëndisje, bizhuteri etj). Festival i Hapur në oborrin e ndërtesës së Sindikatës. Shërbimet të Hapu
	GJENDJA FIZIKE	Ndërtesa Tradicionale Tregtare dykatëshe. Fasadat tradicionale të dyqaneve tregtare, me vitrinat dhe hyrjet. Disejnim i orendive urbane dhe rrugës së shtruar në harmoni me pamjen tradicionale të qytetit. Ri-rregullimi i mobilierisë së rrugës për kafene
	KULTURORE	Ruajtja e modelit tregtar tradicional urban. Inventarizimi dhe dokumentimi i objekteve tregtare në harmoni me arkitekturën tradicionale. Restaurimi i Xhamisë së Sinan Pashës dhe Kishës së Shën Gjergjit., Xhamisë së Sejdi Beut
	TRANSPORTI	Shndrimi i zonës tregtare dhe rrethinës së saj në zonë për këmbësorë. Organizimi i parkingjeve për automjeteve në shërbim të zonës tregtare. Rregullimi i rrugëve shërbyese për limitimin e qarkullimit të automjeteve. Shtruarja e rrugës në harmoni me pamjen

Plani i konservimit dhe zhvillimit të
ZONËS HISTORIKE TË PRIZRENIT

Prof.Dr. Nuredin Sani: GJERGJIT, Dr. Ergin YILMAZ, Turgay Karamel, Pinar ABACILAR, Prof.Dr. Seyyap AKINBAŞI (koordinatori)

CH
WB
Cultural Heritage
without Borders
SWEDEN

Istanbul Technical
University
TURKEY

Fig 5.12. Vendimet Planifikuese për Zonën e Tregut Tradicional

II. BLOQET E NDËRTESAVE TË LARTA

H39

	FUNKSIONI	Prodhimtarit tradicionale afër Teqesë Halveti. Parkim nëntokësor. Shërbime tregtare në katin përdhes. Hotele dhe Ndërtesa Banimi.
	GJENDJA FIZIKE	Tipe të ndërtesave të shkëputura, me lartësi deri në tre kate. Projekti kryesorë i kualitetit të qendrës së qytetit modern në harmoni me proporcionet dhe arkitekturën tradicionale. Rindërtimi dhe riparimi i blloqeve të ndërtesave të larta në mënyrë që të fitohen karakteristikat e arkitekturës tradicionale.
